



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 129

Tiranë – E enjte, 19 shtator 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11268, datë 11.9.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11035
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 19, datë 10.9.2019	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar..... 11035
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 25, datë 9.9.2019	Për deklarimin për punësim të shtetasve të Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut të përkatësisë etnike shqiptare..... 11036
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 438, datë 10.9.2019	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik të nivelit të arsimit të mesëm, shkolla e gjuhëve të huaja “Eurolingua”, Tiranë..... 11039
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 638, datë 3.9.2019	Për ndryshimin e kalendarit kombëtar të vaksinimit..... 11040
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 499, datë 10.9.2019	Për zbatimin e Rezolutës së Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun nr.GFCM/41/2017/6, për aplikimin e numrit IMO..... 11041
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 60, datë 4.9.2019	Për miratimin e udhëzimit “Për stress test-et e bankave”..... 11041
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 31, datë 28.6.2019	Për miratimin e platformës së data bazës për grumbullimin e të dhënave nga shoqëritë ujësjellës-kanalizime..... 11063

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 32, datë 10.7.2019	Për fillimin e procedurës për dënimin administrativ të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë, sh.a.....	11070
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 33, datë 10.7.2019	Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vau-Dejës, sh.a...	11070
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 34, datë 10.7.2019	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 6.10.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Gramsh”, të ndryshuar.....	11072
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 37, datë 11.7.2019	Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër, sh.a..	11072
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 41, datë 27.8.2019	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë, sh.a.....	11074
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 42, datë 30.8.2019	Për dënimin administrativ të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë, sh.a.....	11079
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Rregjina Zefi.....	11079

**DEKRET****Nr. 11268, datë 11.9.2019****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Arben Idris Sulejmani
2. Neshat Besnik Murati
3. Ilmi Fehmi Ismajli
4. Sevdije Musa Ismajli (Xhemajli/Xhemaili)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM**Nr. 19, datë 10.9.2019**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019,
“PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE
TË REGJISTRIMIT NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË
LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Titulli i kreut IV/3, të udhëzimit nr. 10, datë 15.5.2019, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për procedurat e aplikimit dhe të

regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve me diploma të huaja të shkollës së mesme, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë.”.

2. Shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 13, të kreut IV/3, ndryshojnë si më poshtë:

“a) Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, të kandidatëve me diploma të huaja të shkollës së mesme, në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në IAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplomë të përbashkët, të dyfishtë ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me IAL-të e vendeve të BE-së, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuar nga vetë IAL-të.

b) Njohja e dokumentacionit të kandidatëve të pajisur me diploma të huaja të shkollës së mesme, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar dhe pajis me numër matrikullimi studentin, si dhe brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi, ia komunikon IAL-së.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini**

**UDHËZIM****Nr. 25, datë 9.9.2019****PËR DEKLARIMIN PËR PUNËSIM TË
SHTETASVE TË MALIT TË ZI DHE TË
MAQEDONISË SË VERIUT TË
PËRKATËSISË ETNIKE SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 10.5.2019 “Për përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune dhe certifikatë regjistrimi në punë për shtetasit e Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut të përkatësisë etnike shqiptare”,

UDHËZOJ:

1. Shtetasit e Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut të përkatësisë etnike shqiptare ose punëdhënësi i tyre, të cilët bëjnë deklarin për punësimin e tyre, në zyrën përkatëse të punësimit, të pajisen me dokumente që vërteton deklarin e tyre për punësim.

2. I huaji duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton të dhënat e kërkuara në formatin e vërtetimit të deklarin për punësim. Zyrtari përkatës verifikon të dhënat bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe mban një kopje të tyre.

3. Pajisja e të huajit me vërtetimin e deklarin për punësim, të bëhet nga zyra përkatëse e punësimit ku i huaji ushtron aktivitetin e tij, në një afat kohor prej 5 ditë pune që nga dita e dorëzimit.

4. Formatin i vërtetimit të deklarin për punësim është pjesë e këtij udhëzimi.

5. Ngarkohet Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ / ____ / ____

VËRTETIM DEKLARIMI PËR PUNËSIM

Në zbatim të Ligjit nr.108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.304, datë 10.5.2019, vërtetohet se është bërë deklarimi pranë kësaj zyre, mbi punësimin e të huajt, (i cili përjashtohet nga detyrimi i pajisjes me leje pune dhe çertifikatë regjistrimi pune) me të dhënat e mëposhtme:

Z./Znj. _____
Mr./Ms. (Emri Mbiemri / Given name(s) Surname)

Lindur më _____
Born on (Data Muaji Viti / Day Month Year)

në _____
in (Vendlindja / Place and country of birth)

me Shtetësi _____
Nationality

me përkatësi etnike _____
ethnicity

Me profesion _____
Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri _____ / / / / / / / / / / / / / / / /
Type of document and number

Lëshuar më datë _____ e cila skadon më _____
Issued on (Data Muaji Viti / Day Month Year) Valid until (Data Muaji Viti / Day Month Year)

Me adresë _____



Seat and address

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj:

Name of the employer

(Emri i Subjektit)

Me adresë: _____

Seat and address

Ky vërtetim është i vlefshëm deri sa i huaji të vazhdojë të punojë pranë subjektit të deklaruar më sipër.

DREJTOR



URDHËR
Nr. 438, datë 10.9.2019

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONIT ARSIMOR JOPUBLIK
TË NIVELIT TË ARSIMIT TË MESËM,
SHKOLLA E GJUHËVE TË HUAJA
“EUROLINGUA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3 dhe 7 të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të udhëzimit nr. 15, datë 12.07.2013 “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik të nivelit të arsimit të mesëm, shkolla e gjuhëve të huaja “Eurolingua”, Tiranë, licencuar me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin nr. 192, datë 31.7.2003 “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar ‘Eurolingua’”.

2. Institucioni arsimor jopublik i nivelit të arsimit të mesëm, shkolla e gjuhëve të huaja “Eurolingua” ka këto detyrime:

a) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

c) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur që mund të ketë ndaj nxënësit;

d) të dorëzojë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer;

e) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në

zbatim të këtij urdhri, të mbulohen nga institucioni përkatës i arsimit parauniversitar privat.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik të nivelit të arsimit të mesëm, shkolla e gjuhëve të huaja “Eurolingua”;

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit për arkivat, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor jopublik i nivelit të arsimit të mesëm, shkolla e gjuhëve të huaja “Eurolingua”.

4. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personin juridik që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1, i cili nuk zbaton këtë urdhër.

5. Urdhri nr. 192, datë 31.7.2003, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar ‘Eurolingua’”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe institucioni arsimor jopublik i nivelit të arsimit të mesëm, shkolla e gjuhëve të huaja “Eurolingua”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini



URDHËR
Nr. 638, datë 3.9.2019

PËR NDRYSHIMIN E KALENDARIT
KOMBËTAR TË VAKSINIMIT

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 30, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, i ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 15/2016, datë 10.3.2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, referuar vendimit të Komitetit Kombëtar të Imunizimit nr. 2, datë 12.4.2018,

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e kalendarit të vaksinimit, si më poshtë vijon:

a) fëmijët e lindur që nga data 1 gusht 2019, do të fillojnë kalendarin e vaksinimit me vaksinën e Rotavirusit, vaksinë e gjallë dhe e dobësuar, e cila merret nga goja;

b) vakcina e Rotavirusit futet në kalendarin kombëtar të vaksinimit me 3 doza, përkatësisht në moshat 2, 4 dhe 6 muaj;

c) fëmija i lindur më 1 gusht 2019, që mbush moshën 2 muaj, më 1 tetor 2019, fillon vaksinimin me këtë vaksinë;

d) vakcina e Rotavirusit do të administrohet në të njëjtën ditë me vaksinat e tjera të kalendarit, DTP-HepB-Hib, PCV13 dhe IPV/OPV.

2. Operatori i Kujdesit Shëndetësor, në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik të

koordinojnë të gjithë veprimtarinë për fillimin e vaksinimit me këtë vaksinë, më 1 tetor 2019, në të gjithë vendin.

3. Operatori i Kujdesit Shëndetësor, të njihet me kalendarin e ri të vaksinimit dhe rekomandimet e Institutit të Shëndetit Publik, si edhe të marrë masa për zbatimin e tyre në të gjitha njësitë vendore të kujdesit shëndetësor.

4. Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor të marrin masa dhe të sigurojnë shpërndarjen, ruajtjen dhe aplikimin në kushtet standarde të vaksinës së Rotavirusit.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor:

a) të njihet me kalendarin e ri të vaksinimit, si edhe të marrë masa për zbatimin e tyre nga çdo Qendër Shëndetësore;

b) të sigurojë kartelat e reja sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit, bashkëngjitur këtij urdhri;

c) të sigurojë regjistrat e vaksinimit, sipas kalendarit të ri të vaksinimit për çdo qendër shëndetësore.

6. Ngarkohen Instituti i Shëndetit Publik, Operatori i Kujdesit Shëndetësor, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin dhe monitorimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

Kalendari i vaksinimit për fëmijët 0-18 vjeç

SËMUNDJA	Mosha në muaj					Mosha në vite				
	Në lindje	2 muaj	4 muaj	6 muaj	12 muaj	2 vjeç	5 vjeç	6 vjeç	14 vjeç	18-19 vjeç
Tuberkuloz	BCG									
Hepatit viral B	HepB									
Difteri, Tetanoz, Pertusis, Hepatit viral B, Infeksione nga <i>Haemophilus influenzae</i> tip b		DTP-HepB-Hib	DTP-HepB-Hib	DTP-HepB-Hib						
Poliomielit		IPV	IPV	bOPV		IPV/b OPV		IPV/b OPV		
Infeksione nga Rotavirus		Rota-1	Rota-2	Rota-3						
Infeksione nga		PCV	PCV		PCV					



Pneumokoku (<i>Streptococcus pneumoniae</i>)									
Difteri, Tetanoz, Pertusis					DTP				
Fruth, Rubeolë, Parotit				FRP		FRP			
Difteri, Tetanoz							DT		
Difteri, Tetanoz								Td	Td

URDHËR

Nr. 499, datë 10.9.2019

**PËR ZBATIMIN E REZOLUTËS TË
KOMISIONIT TË PËRGJITHSHËM TË
PESHKIMIT PËR MESDHEUN NR.
GFCM/41/2017/6, PËR APLIKIMIN
E NUMRIT IMO**

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 3 dhe 5, të ligjit nr. 9093, datë 3.7.2003 “Për ratifikimin e Marrëveshjes për Krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pajisjen me numër IMO, të të gjitha anijeve shqiptare të peshkimit mbi 24 m, brenda datës 30 shtator 2019.

2. Anijet, që brenda afatit sipërcituar, nuk janë pajisur me numër IMO, nuk do të lejohen të ushtrjnë aktivitetin e peshkimit.

3. Aplikimi është falas dhe bëhet në faqen elektronike të IMO <https://imonumbers.ihs.com/>

4. Pika 1 e urdhrit nuk zbatohet për anijet me strukturë të drunjtë, të cilat mund të aplikojnë vullnetarisht për pajisjen me numër IMO.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi**

VENDIM

Nr. 60, datë 4.9.2019

**PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR
STRESS TEST-et E BANKAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe neni 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të nenit 58, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë udhëzimin “Për stress test-et e bankave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinën Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1 mars 2020.

**KRYETAR
Gent Sejko**

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kërkesave dhe metodologjive mbi kryerjen e stress test-eve nga bankat, si pjesë e procesit të tyre të administrimit të rrezikut.



Neni 2 Subjektet

Subjekte të këtij udhëzimi janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, të cilat për thjeshtësi, këtu e më poshtë në këtë udhëzim, do të quhen “banka”.

Neni 3 Baza ligjore

Ky udhëzim nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të nenit 58, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë “Ligji për bankat”), në ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”), si dhe në akte të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) **“stress test i kapitalit (mjaftueshmërisë së kapitalit)”** – është vlerësimi i ndikimit të skenarëve të caktuar makroekonomikë ose mikroekonomikë, mbi pozicionin e përgjithshëm të kapitalit të bankës, duke përfshirë edhe ndikimin mbi kërkesat minimale për kapital ose mbi kërkesat shtesë për kapital, nëpërmjet projektimit të burimeve dhe kërkesave të kapitalit të bankës, duke theksuar dobësitë e bankës dhe duke vlerësuar kapacitetin për të absorbuar/përthithur humbjet dhe ndikimin në pozicionin e kapitalit (mjaftueshmërinë e kapitalit);

b) **“stress test i likuiditetit”** – është vlerësimi i ndikimit të skenarëve të caktuar makroekonomikë ose mikroekonomikë nga këndvështrimi i

financimit dhe i likuiditetit, si dhe i goditjeve në pozicionin e përgjithshëm të likuiditetit të bankës, duke përfshirë edhe ndikimin në kërkesat minimale rregullatore ose në kërkesat shtesë për likuiditet;

c) **“supozim i bilancit statik”** – është një supozim metodologjik, sipas të cilit, ndikimi i skenarëve të stress test-it duhet të matet mbi hipotezën e një “bilanci të pandryshueshëm/konstant” dhe të një “modeli biznesi të pandryshueshëm ose të qëndrueshëm”, përgjatë gjithë periudhës së parashikimit/projeksionit.

Supozimi i bilancit statik:

i) për llogaritjen e ndikimit të skenarëve, nuk lejon marrjen në konsideratë të ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet e bankës, që rrjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga:

- veprimet/masat e organeve drejtuese të bankës;

- rritjet e portofolit të kredive ose rritjet e rikuperimit të kredive me probleme;

- ndryshimet në maturitet ose në karakteristika të tjera të këtyre aktiveve ose detyrimeve.

Përjashtimisht sa parashikohet më sipër, zbatimi i metodologjisë së stress test-it, mund të ndryshojë madhësinë dhe përbërjen e bilancit dhe veçanërisht, bazën e kapitalit, gjatë periudhës së parashikimit/projeksionit për shkak të, për shembull, dështimeve të reja (përkeqësimit të cilësisë së aktiveve), provigjioneve të reja, ose të rritjes së rregullimeve të vlerës së aktiveve financiare;

ii) lejon përfshirjen e aktiveve dhe të detyrimeve të reja, për aq kohë sa këto zëra kanë të njëjtat karakteristika kryesore (maturitet, profil rreziku etj.), me ato ekzistuese;

d) **“supozim i bilancit dinamik”** – është një supozim metodologjik, sipas të cilit ndikimi i skenarit të stress test-it duhet të matet mbi mundësinë e një “bilanci të ndryshueshëm/jo konstant” dhe të një “modeli biznesi në zhvillim”, përgjatë gjithë periudhës së parashikimit/projeksionit. Sipas supozimit të bilancit dinamik, rezultati i stress test-it pasqyron një kombinim të skenarit të përdorur dhe të veprimeve/masave të ndërmarra nga organet drejtuese të bankës. Veprimet/masat e ndërmarra nga organet drejtuese mund të jenë detyruese ose jodetyruese (p.sh. ndërhyrjet e planifikuara që në fillim dhe të pavarura nga skenari dhe/ose ndërhyrjet e kushtëzuara nga skenari i stress test-it);



e) **“stress test në nivel portofoli”** – është stress test-i i kryer mbi një portofol individual ose mbi disa portofola të bankës, duke u përqendruar në pasojat e goditjeve nga një faktor i vetëm rreziku ose nga shumë faktorë rreziku;

f) **“analizë e ndjeshmërisë”** – është stress test-i që mat ndikimin potencial të një faktori specifik me një rrezik të vetëm, ose të disa faktorëve të thjeshtë me shumë rreziqe, që ndikojnë në kapitalin ose likuiditetin e bankës, në një portofol të veçantë të saj, ose te banka në tërësi;

g) **“analizë e skenarëve”** – është vlerësimi i qëndrueshmërisë së bankës ose i një portofoli të saj, ndaj një skenari të caktuar, që përfshin një grup faktorësh rreziku, që kanë të gjitha karakteristikat e mëposhtme:

i) faktorët e rrezikut lidhen në mënyrë të qëndrueshme (konsistente) së brendshmi me njëri-tjetrin;

ii) faktorët e rrezikut që formojnë grupin përkatës të faktorëve, supozojnë ndodhjen e njëkohshme të ngjarjeve të ardhshme, që mbulojnë një tërësi rreziqesh dhe fushash të biznesit; dhe

iii) grupi i faktorëve të rrezikut ka për qëllim gjithashtu të zbulojë natyrën e rreziqeve të lidhura midis portofolave dhe përgjatë periudhave, ndërveprimet në nivel sistemi dhe efektet e raundit të dytë;

h) **“stress test i anasjellë”** – është stress test-i i bankës, i cili bazohet në identifikimin e rezultatit të paracaktuar (për shembull, pikat në të cilat modeli i biznesit të bankës bëhet i porealizueshëm/ i paqëndrueshëm ose në të cilin banka mund të konsiderohet të jetë pranë një situate të paafëtisë pague, sipas kuptimit të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”) dhe më pas shqyrton/vlerëson skenarët dhe rrethanat që mund të shkaktojnë këtë rezultat. Stress test-i i anasjellë ka një ose disa nga karakteristikat e mëposhtme:

i) përdoret si një mjet i administrimit të rrezikut që synon rritjen e ndërgjegjësimit të bankës për dobësitë e saj, ku banka identifikon dhe vlerëson në mënyrë të qartë skenarët (ose kombinimin e skenarëve) që çojnë në një rezultat të paracaktuar;

ii) banka vendos për llojin dhe kohën (ngjarjet aktivizuese) e veprimeve/masave të organeve drejtuese të bankës ose veprimeve të tjera, të nevojshme për të korrigjuar dështimet ose problemet e tjera në veprimtarinë e saj dhe për të harmonizuar oreksin/tolerancën ndaj rrezikut, me

rreziqet aktuale të identifikuar nga stress test-i i anasjellë;

iii) stress test-i i anasjellë specifik mund të zbatohet gjithashtu edhe në kontekstin e planeve të rimëkëmbjes (p.sh. stress test-et e anasjella të zbatuara në një kontekst më të gjerë mund të përdoren për stress test-et e planit të rimëkëmbjes, duke identifikuar kushtet për të cilat mund të nevojitet të planifikohet rimëkëmbja);

i) **“backtesting”** – është procesi i krahasimit të humbjeve të parashikuara nga modeli (teknika e përdorur nga banka), me humbjet e ndodhura realisht gjatë periudhës së testimit. Shërben si një mjet i rëndësishëm për vlerësimin e vlefshmërisë së modelit (teknikës së përdorur), që është një proces për vlerësimin nëse modeli (teknika e përdorur) është i përshtatshëm. Qëllimi kryesor i backtesting është të sigurojë, me një nivel të caktuar besimi, se humbjet aktuale nuk i tejkalojnë humbjet e pritshme;

j) **“efekte të raundit të dytë”** – janë efektet (që mund të mos kufizohen vetëm në efekte makroekonomike) e shkaktuara nga përgjigjja e bankave të veçanta ndaj një goditjeje fillestare të jashtme, të cilat në mënyrë të agreguar, do ta zmadhonin goditjen fillestare, duke shkaktuar në këtë mënyrë, një efekt negativ shtesë;

k) **“ashpërsia e skenarit”** – nënkupton nivelin e ashpërsisë së supozimeve ose të përkeqësimit të skenarit (nga skenari bazë në skenarin e rënduar), të shprehur në terma të treguesve bazë makroekonomikë dhe financiarë (ose ndonjë supozimi tjetër). Ashpërsia më e madhe e skenarit, në përgjithësi, shoqërohet me nivelin më të lartë të humbjeve të bankës.

l) **“besueshmëria/zbatueshmëria e skenarit”** – nënkupton nivelin në të cilin një skenar mund të konsiderohet si i mundshëm për t’u materializuar, duke marrë parasysh qëndrueshmërinë e marrëdhënieve të këtij skenari me treguesit aktualë makroekonomikë dhe financiarë, mbështetjen e skenarit në përshkrime të qarta/të kuptueshme si dhe në shpërndarjen probabilitare dhe të dhënat historike. Përcaktimi i besueshmërisë/ zbatueshmërisë së skenarit nuk duhet të kufizohet vetëm në të dhënat historike dhe për këtë arsye, një rol kyç duhet të luajnë gjykimet e ekspertëve, që marrin parasysh ndryshimin e mjedisit të rrezikut (për shembull, thyerjet strukturore të vërejtura) dhe ngjarjet e



stresit që janë vërejtur në mjedise me rrezik të ngjashëm, jashtë përvojës së drejtpërdrejtë historike të bankës. Banka mund të përdorë gjithashtu edhe metodat e simulimit (si p.sh. simulimet Monte Carlo);

m) **“vlerësim në një moment kohor (point in time)”** – është procesi ku vlerësimi/pikëzimi i brendshëm i bankës pasqyron një vlerësim të gjendjes aktuale të huamarrësit dhe/ose gjendjes së ardhshme të tij, përgjatë një horizonti kohor të përcaktuar. Në këtë mënyrë, vlerësimi/pikëzimi i brendshëm ndryshon, me ndryshimin e gjendjes së huamarrësit gjatë ciklit të kredisë/biznesit. Një vlerësim në një moment kohor mat rrezikun e dështimit, përgjatë një horizonti të shkurtër kohor, që maksimalisht shtrihet deri në një vit;

n) **“vlerësim përgjatë ciklit (through the cycle)”** – është procesi i vlerësimit të rrezikut të huamarrësit, sipas një skenari të rastit më të keq të mundshëm, që do të tregonte gjendjen e tij në situatë stresi. Në këtë rast, vlerësimi/pikëzimi i huamarrësit do të vazhdojë të mbetet i njëjtë gjatë ciklit të kredisë/biznesit. Vlerësimi përgjatë ciklit përfshin një horizont kohor, mjaftueshëm të gjatë, që efektet e ciklit të biznesit të shuhet. Si rregull, mund të konsiderohet një periudhë prej pesë apo më shumë vitesh;

o) **“rrezik i vendit”** – është rreziku i ekspozimit ndaj humbjeve, i shkaktuar nga ngjarje të ndodhura në një vend të huaj. Ky rrezik lidhet me të gjitha format e investimit apo të kredidhënies së bankës ndaj individëve, shoqërive tregtare (korporatave), bankave ose qeverive të vendeve të huaja;

p) **“rrezik i financimit”** – është rreziku që banka të mos ketë burime të qëndrueshme financimi në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, që do të rezultonte në rrezikun aktual apo të ardhshëm, që banka të mos përmbushë detyrimet financiare që maturohen në periudhë afatmesme apo afatgjatë, ose pa rritur kostot e financimit;

q) **“rrezik i modelit”** – është mundësia e humbjeve të bankës, si pasojë e vendimeve të marra prej saj, bazuar kryesisht në rezultatet e modeleve të brendshme, të shkaktuara nga gabimet në zhvillimin, zbatimin ose përdorimin e këtyre modeleve;

r) **“rrezik i migrimit”** – është rreziku që lidhet me përkeqësimin e aftësisë paguese, ose me përkeqësimin e vlerësimit të cilësisë së kredisë të

huamarrësit, në rastin kur ekziston një vlerësim i tillë, që materializohet në rritjen e rrezikut të dështimit;

s) **“probabilitet i dështimit (PD)”** – është probabiliteti që huamarrësit të dështojnë, për çdo shkallë vlerësimi, i cili tregon përqindjen mesatare të huamarrësve që dështojnë në këtë shkallë vlerësimi përgjatë një viti;

t) **“ekspozim në dështim (EAD)”** – është vlerësimi i tepicës së ekspozimit (shuma e tërhequr e ekspozimit plus suma e pritshme për t'u tërhequr në të ardhmen, nga pjesa e papërdorur e tij), në momentin që huamarrësi dështon në shlyerjen e detyrimeve;

u) **“humbje në rast dështimi (LGD)”** – është vlera e ekspozimit që banka mund të humbasë përfundimisht, në rast se huamarrësi dështon. Këto humbje zakonisht shprehen si përqindje e ekspozimit në dështim dhe varen ndër të tjera, nga lloji dhe vlera e garancisë/kolateralit, lloji i huamarrësit dhe nga të ardhurat e pritshme nga ekzekutimi i aktiveve;

v) **“humbja e pritshme”** – vlerësohet mbi bazën e probabilitetit të dështimit, ekspozimit në dështim dhe humbjes në rast dështimi;

x) **“norma e rikuperimit (recovery rate)”** – llogaritet në bazë të pagesave historike të huamarrësve, ku vlerat e pritshme dhe intervalet e besimit përcaktojnë gamën e normave të mundshme të rikuperimit;

y) **“periudha kohore e mbijetesës”** – nënkupton periudhën gjatë së cilës banka ushtron veprimtarinë në kushte të stresuara dhe ende vazhdon të përmbushë detyrimet e saj;

z) **“agregimi i të dhënave mbi rrezikun”** – përfshin përcaktimin, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të rrezikut, sipas kërkesave të raportimit të rrezikut të bankës, për t'i mundësuar bankës, matjen e performancës së saj kundrejt oreksit/tolerancës ndaj rrezikut. Në këtë proces përfshihet edhe përzgjedhja, bashkimi apo zbrëthimi i të dhënave;

aa) **“infrastruktura e të dhënave”** – përfshin strukturat fizike dhe organizative, për të krijuar dhe ruajtur të dhënat dhe sistemet e teknologjisë dhe të informacionit (TI), me qëllim që të mbështesin agregimin e të dhënave të bankës mbi rrezikun dhe procedurat e brendshme të raportimit të rrezikut;

bb) **“banka me rëndësi sistematike”** – janë bankat e licencuara dhe që ushtrojnë veprimtari në



Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara si të tilla, sipas vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë.

Neni 5

Periodiciteti i kryerjes së stress test-eve

1. Banka kryen stress test-et, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, me një frekuencë të përshtatshme, si pjesë përbërëse e sistemit të saj të administrimit të rrezikut.

2. Periodiciteti me të cilin bankat kryejnë stress test-et, si dhe raportimi i rezultateve të tyre, përcaktohet duke pasur parasysh fushën e veprimit dhe llojin e stress test-it, madhësinë dhe kompleksitetin e bankës sipas parimit të proporcionalitetit, karakteristikat e portofolit, si dhe ndryshimet në mjedisin makroekonomik ose veprimtaritë e bankës.

3. Periodiciteti i realizimit të stress test-eve duhet të jetë të paktën 2 (dy) herë në vit për bankat me rëndësi sistemike dhe të paktën 1 (një) herë në vit për bankat me rëndësi josistemike, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në akte të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

4. Banka e Shqipërisë mund t'i kërkojë në çdo rast bankës kryerjen e stress test-eve në periudha më të shpeshta dhe/ose sipas skenarëve me supozime të përcaktuara.

KREU II

PËRMBAJTJA E STRESS TEST-eve

Neni 6

Programi i stress test-eve

1. Banka harton një program të stress test-eve, i cili përfshin të paktën:

a) llojet e stress test-eve, objektivat kryesorë si dhe fushën e zbatimit të tyre;

b) frekuencën e ushtrimeve të ndryshme të stress test-eve;

c) kuadrin e brendshëm të drejtimit, me përgjegjësi dhe procedura të përcaktuara qartë;

d) në rastin e një grupi bankar, subjektet e grupit që i nënshtrohen konsolidimit, si dhe mbulimin e stress test-eve sipas llojeve të rrezikut dhe portofolave;

e) infrastrukturën përkatëse të të dhënave;

f) të dhëna të detajuara për metodologjinë, që përfshijnë edhe modelet e përdorura dhe lidhjet e mundshme midis stress test-eve të likuiditetit dhe

të kapitalit, duke përcaktuar madhësinë e këtyre lidhjeve dhe duke identifikuar efektet e raundit të dytë;

g) tërësinë e supozimeve, duke përfshirë veprimtaritë e biznesit dhe veprimet/masat e organeve drejtuese, si dhe veprimet korrigjuese të parashikuara për secilin stress test; dhe

h) frekuencën e rishikimit të modeleve, ndryshimet e kryera dhe arsyet përkatëse.

2. Banka mbizotëruese në një grup bankar zhvillon një program të stress test-eve për grupin bankar. Programi miratohet nga këshilli drejtues i bankës mbizotëruese dhe monitorohet nga drejtoria/drejtuesit ekzekutivë, në kontekstin e politikës së centralizuar të bankës për administrimin e rrezikut. Programi i stress test-eve në nivel grupi përfshin dhe adreson në masën e duhur, të gjitha subjektet e grupit që i nënshtrohen konsolidimit.

3. Në rast se një bankë është pjesë e një grupi të huaj bankar, ajo harton programin individual të stress test-eve, duke marrë parasysh rreziqet specifike ndaj të cilave është e ekspozuar. Nëse banka merr pjesë në stress test-et në nivel grupi dhe rezultatet e këtyre stress test-eve tregojnë dobësi shtesë, banka i konsideron këto rezultate, në planifikimin e kapitalit dhe të likuiditetit, si dhe në administrimin e rrezikut të saj.

4. Banka përfshin në programin e saj të stress test-eve, edhe stress test-in e anasjellë dhe skenarët përkatës.

5. Banka vlerëson rregullisht programin e saj të stress test-eve, si dhe e përditëson atë në mënyrë të përshtatshme. Vlerësimi duhet të bëhet të paktën në bazë vjetore, mbështetur në një analizë sasiore dhe cilësore dhe duhet të pasqyrojë plotësisht ndryshimin e kushteve të jashtme dhe të brendshme. Banka, gjatë vlerësimit të programit të stress test-eve, merr në konsideratë, të paktën:

a) efektivitetin e programit në përmbushjen e qëllimeve të synuara;

b) nevojën për përmirësime;

c) faktorët e identifikuar të rrezikut, përkufizimet dhe arsyetimet për skenarët përkatës, supozimet e modelit (teknikës së përdorur nga banka) dhe ndjeshmërinë e rezultateve ndaj këtyre supozimeve, si dhe rolin e gjykimit të ekspertëve, për të siguruar që ai shoqërohet edhe me një analizë të plotë;



d) performancën e modelit (teknikës së përdorur nga banka);

e) mënyrën dhe përshtatshmërinë e ndërlidhjeve të mundshme midis stress test-eve të kapitalit dhe të likuiditetit;

f) udhëzimet/vlerësimet e marra nga Banka e Shqipërisë në kuadër të stress test-eve;

g) mjaftueshmërinë e infrastrukturës së të dhënave (implementimi i sistemeve dhe cilësia e të dhënave);

h) nivelin e përfshirjes së organeve drejtuese të bankës;

i) të gjitha supozimet, përfshirë supozimet e biznesit dhe/ose të drejtimit, si dhe veprimet/masat e organeve drejtuese të parashikuara, bazuar në qëllimin, llojin dhe rezultatin e stress test-eve, duke përfshirë një vlerësim të zbatueshmërisë së veprimeve/masave të organeve drejtuese të bankës në situatat e stresit dhe në një mjedis të ndryshueshëm të biznesit; dhe

j) përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e dokumentacionit përkatës.

6. Banka siguron që analiza e saj sasiore, në përputhje me pikën 5 të këtij neni, përfshin elemente të përshtatshme për backtesting, për të vërtetuar supozimet, parametrat dhe rezultatet e modeleve (teknikave) të stress test-eve (për shembull: modeleve të rrezikut të kredisë, modeleve të rrezikut të tregut). Banka siguron që analiza e saj cilësore, në përputhje me pikën 5 të këtij neni, është mbështetur në gjykimet e ekspertëve ose në vlerësimet e benchmarks.

7. Banka dokumenton programin e stress test-eve dhe rezultatet e tyre, në mënyrë të përshtatshme, për të gjitha llojet e stress test-eve të kryera, në nivel individual rreziku dhe/ose në nivel portofoli, si dhe në nivel banke.

8. Programi i stress test-eve duhet të njihet në të gjithë bankën, por veçanërisht të vlerësohet nga komiteti i rrezikut (nëse ekziston) dhe nga njësia e kontrollit të brendshëm. Njësitë e biznesit që nuk janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e programit dhe/ose ekspertët e jashtëm që nuk janë të përfshirë në procesin e hartimit dhe zbatimit të programit, duhet të luajnë një rol kyç në vlerësimin e këtij procesi, duke marrë në konsideratë ekspertizën përkatëse për çështje specifike.

9. Banka sigurohet që për hartimin fillestar dhe për vlerësimin e programit të stress test-eve, është zhvilluar një dialog efektiv, me përfshirjen e

ekspertëve nga të gjitha linjat e biznesit të bankës, si dhe që programi dhe përditësimet e tij janë rishikuar në mënyrë të duhur nga organet drejtuese të bankës, të cilët janë gjithashtu përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij.

Neni 7

Roli dhe përgjegjësitë e drejtimit të bankës

1. Këshilli drejtues miraton programin e stress test-eve dhe drejtoria (drejtuesit ekzekutivë) monitoron zbatimin e tij.

2. Këshilli drejtues dhe drejtoria (drejtuesit ekzekutivë) duhet të kenë njohuri mbi ndikimin e ngjarjeve të stresit, në profilin e përgjithshëm të rrezikut të bankës, si dhe kuptojnë saktë aspektet më të rëndësishme të programit të stress test-eve, që iu mundësojnë:

a) të përfshihen në mënyrë aktive gjatë marrjes së masave dhe diskutimeve për stress test-et e bankës;

b) të sfidojnë supozimet kryesore të hartimit të stress test-eve, përzgjedhjen e skenarëve dhe supozimet e përdorura për stress test-et në përgjithësi; dhe

c) të vendosin për veprimet/masat e nevojshme të organeve drejtuese dhe, në rastet kur nga rezultatet e stress test-eve identifikohen mangësi materiale/të rëndësishme, i diskutojnë këto veprime/masa me Bankën e Shqipërisë.

3. Banka zbaton programin e stress test-eve në përputhje me politikat dhe procedurat e brendshme përkatëse të saj. Drejtoria (drejtuesit ekzekutivë) sigurohet se janë caktuar përgjegjësi të qarta dhe burime të mjaftueshme (burime njerëzore të kualifikuara dhe sisteme të teknologjisë së informacionit) për zbatimin e programit të stress test-eve.

4. Programi i stress test-eve është pjesë përbërëse e sistemit të administrimit të rrezikut të bankës dhe mbështet vendimet dhe proceset e ndryshme të lidhura me veprimtarinë e bankës, si dhe planifikimin strategjik, duke përfshirë edhe planifikimin e kapitalit dhe të likuiditetit.

5. Banka vlerëson rezultatet e stress test-eve dhe i merr në konsideratë, gjatë planifikimit strategjik të saj (bankës), në procesin e përcaktimit të oreksit/tolerancës dhe kufijve të rrezikut dhe kur merr të gjitha vendimet përkatëse që ndikojnë



kapitalin, likuiditetin, planet e rimëkëmbjes dhe planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 8

Infrastruktura dhe agregimi i të dhënave

1. Programi i stress test-eve mbështetet nga një infrastrukturë e përshtatshme e të dhënave, e cila:

a) lejon fleksibilitetin dhe nivelet e duhura të cilësisë dhe kontrollit;

b) është në përputhje me parimin e proporcionalitetit;

c) kërkon angazhimin e burimeve të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe materiale në secilin nivel të drejtimit, për të garantuar zhvillimin efektiv dhe mirëmbajtjen e saj, përfshirë edhe sistemet e TI-së.

2. Banka përfshin infrastrukturën e të dhënave për stress test-et, si pjesë të infrastrukturës së përgjithshme të TI-së.

3. Banka mban të dhëna të sakta, të besueshme dhe të përditësuara për rreziqet, në mënyrë që të kryejë stress test-e të besueshme.

4. Banka siguron që agregimi i të dhënave të saj të rrezikut, karakterizohet nga:

a) saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të rrezikut, që sigurohet nga agregimi i të dhënave kryesisht në formë të automatizuar, me qëllim që të minimizohet mundësia e gabimeve;

b) plotësia, që sigurohet nga fakti që të dhënat e rrezikut përfshijnë plotësisht edhe rreziqet që rrjedhin nga ekspozimet jashtë bilancit dhe janë lehtësisht të përdorshme në çdo nivel të bankës.

5. Banka siguron informacion të agreguar mbi rrezikun në kohën e duhur, për të përmbushur të gjitha kërkesat raportuese gjatë gjithë procesit të kryerjes së stress test-eve, që lindin nga nevojat e brendshme të bankës ose nga kërkesat mbikëqyrëse. Banka krijon një strukturë efikase që siguron respektimin e afateve kohore.

Neni 9

Procesi i raportimit brenda bankës

1. Banka siguron që procesi i raportimit për qëllime të stress test-eve brenda bankës:

a) mbështetet plotësisht nga kapacitetet e agregimit të të dhënave;

b) transmeton me saktësi të dhënat e agreguara të rrezikut dhe pasqyron rrezikun në mënyrë të saktë;

c) përfshin të gjitha rreziqet materiale dhe në veçanti, lejon identifikimin e dobësive të reja që mund të vlerësohen potencialisht, edhe në të njëjtin ushtrim të stress test-it;

d) ofron ose është në gjendje të ofrojë informacione shtesë, në lidhje me supozimet kryesore, nivelet e tolerancës ose përjashtimet;

e) komunikon informacionin në një mënyrë të qartë dhe të saktë duke përfshirë informacionin e rëndësishëm, të përshtatur sipas nevojave të marrësve/përdoruesve të informacionit.

KREU III

QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT TË STRESS TEST-eve

Neni 10

Kërkesa të përgjithshme

1. Stress test-et marrin në konsideratë të gjitha llojet e rreziqeve materiale, që lidhen me aktivet dhe detyrimet, brenda dhe jashtë bilancit të bankës.

2. Stress test-et identifikojnë rreziqet në nivele të ndryshme në një bankë. Në këtë aspekt, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, qëllimi i stress test-it mund të ndryshojë nga një analizë e thjeshtë e ndjeshmërisë, në nivel portofoli ose analizë e rrezikut, në nivel individual, në një stress test gjithëpërfshirës me skenar, në nivel banke dhe grupi.

3. Stress test-et, kur është e mundur, duhet të marrin parasysh edhe faktin që korrelacionet (ndërlidhjet) midis faktorëve të rrezikut dhe llojeve të rreziqeve, kanë tendencë të rriten gjatë situatave të vështirësive ekonomike ose financiare.

4. Banka përcakton ndikimin e stress test-eve të çdo rreziku material, në terma sasiorë, aty ku është e përshtatshme:

a) për stress test-et e kapitalit: mbi të ardhurat dhe pozicionin e përgjithshëm të kapitalit të bankës, duke përfshirë edhe ndikimin mbi kërkesat minimale ose mbi kërkesat shtesë për kapital;

b) për stress test-et e likuiditetit: mbi pozicionin e përgjithshëm të likuiditetit të bankës, nga këndvështrimi i financimit dhe pozicionit të likuiditetit të tregut, duke përfshirë edhe ndikimin mbi kërkesat minimale rregullatore ose mbi kërkesat shtesë.



Neni 11

Stress test-et në nivel rreziku individual dhe në nivel portofoli

1. Banka kryen stress test-e në nivel portofoli individual, duke përfshirë të gjitha llojet e rreziqeve që ndikojnë në këto portofola dhe duke përdorur si analizat e ndjeshmërisë, ashtu edhe analizat e skenarëve. Banka gjithashtu identifikon faktorët e rrezikut dhe nivelin përkatës të goditjes, kur është e mundur, në nivel portofoli individual.

2. Banka kryen stress test-e për portofolat dhe linjat ose njësitë e biznesit, për të identifikuar përqendrimet brenda të njëjtit lloj rreziku dhe midis llojeve të ndryshme të rreziqeve - p.sh. të faktorëve të ngjashëm të rrezikut brenda një lloj rreziku dhe midis llojeve të ndryshme të rreziqeve.

3. Banka, në rastet kur merr parasysh përqendrimet midis llojeve të ndryshme të rreziqeve, i agregon këto rreziqe, veçanërisht rrezikun e tregut dhe rrezikun e kredisë, për të siguruar një vlerësim më të mirë të përqendrimeve potenciale të rrezikut në një situatë stresi. Banka identifikon lidhjet e mundshme midis ekspozimeve, të cilat mund të shfaqin rrezik gjatë vështirësive ekonomike ose financiare, si dhe supozimet rreth varësive dhe korrelacioneve midis llojeve të rreziqeve, në një situatë stresi.

Neni 12

Stress test-et në nivel banke dhe grupi

1. Banka, kur kryen stress test-e në nivel banke dhe grupi, merr në konsideratë se:

a) rreziqet në nivel banke mund të mos reflektohen tërësisht nëpërmjet një agregimi të thjeshtë të stress test-eve në nivel portofoli, rreziqesh individuale ose njësisë biznesi të bankës/grupit;

b) korrelacionet, netimi/kompensimi i ekspozimeve dhe përqendrimeve individuale mund të çojnë në numërimin e dyfishtë të rreziqeve ose në një nënvlerësim të ndikimit të faktorëve të stresuar të rrezikut; dhe

c) rreziqet specifike të grupit mund të shfaqen në nivel banke.

Neni 13

Parimi i proporcionalitetit

1. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, programi i stress-test-eve të bankës duhet të

përshtatet me profilin e saj individual të rrezikut dhe me modelin e biznesit.

2. Banka merr parasysh madhësinë, organizimin e brendshëm, natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të saj, gjatë zhvillimit dhe zbatimit të programit të stress test-eve. Bankat me rëndësi sistematike inkurajohen të hartojnë programe të avancuara/sofistikuara të stress test-eve, ndërsa bankat me rëndësi josistematike mund të zbatojnë programe më të thjeshta.

KREU IV

LLOJET E STRESS TEST-EVE

Neni 14

Kërkesa të përgjithshme

1. Paraqitja, kompleksiteti dhe niveli i detajimeve të metodologjive të stress test-it duhet të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe duhet të marrin në konsideratë strategjinë dhe modelin e biznesit, si dhe karakteristikat e portofolit të bankës.

2. Stress test-et e kryera për qëllime të procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit duhet të jenë në përputhje me oreksin/tolerancën ndaj rrezikut dhe strategjinë e përgjithshme të bankës (përfshirë edhe strategjinë e biznesit të saj).

3. Skenarët apo supozimet e përshkruara për qëllime të stress test-eve të Bankës së Shqipërisë, nuk zëvendësojnë stress test-et që bankat duhet të kryejnë për qëllime të procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit.

4. Banka identifikon mënyra të përshtatshme, të qarta dhe të qëndrueshme për transformimin e faktorëve të rrezikut në parametrat përkatës të brendshëm të rrezikut (si probabilitetin e dështimit (PD), humbjet në rast dështimi (LGD), fshirjet nga bilanci, haircut-et e zbatuara mbi vlerën e drejtë etj.), të cilat ofrojnë një pamje të plotë mbi rreziqet e bankës dhe të grupit.

5. Lidhja midis faktorëve të stresuar të rrezikut dhe parametrave të rrezikut nuk duhet të bazohet vetëm në përvojën historike dhe analizën e bankës, por duhet të plotësohet, kur është e mundur dhe e përshtatshme, me benchmarks nga burime të jashtme dhe nga udhëzimet/orientimi i mbikëqyrësve.



6. Banka, kur përcakton skenarët/faktorët e rrezikut hipotetikë dhe makroekonomikë, për shkak të kompleksitetit të përfshirë në modelimin e tyre, duhet të njohë edhe rrezikun e modelit (teknikës) të përfshirë dhe siguron se janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

a) është kryer nga ekspertët një rishikim i rregullt dhe konservator i supozimeve dhe mekanikës së modelit (teknikës së përdorur nga banka), si dhe është ndjekur një metodë konservatore modeli për të marrë në konsideratë edhe rrezikun e modelit;

b) është zbatuar një shkallë e mjaftueshme konservatorizmi, sipas rastit, për supozimet që janë të vështira për t'u matur në mënyrë sasiore (p.sh. efekti i diversifikimit, rritja eksponenciale e projektuar, komisionet e projektuara, pikëpamjet e drejtimit të bankës të orientuara nga e ardhmja), por që mund të kenë ndikim në rezultatet e modelit (p.sh. rezultatet e modelimit të të ardhurave neto para fondeve rezervë duhet të kenë mbështetje statistikore si dhe konsiderata të biznesit); dhe

c) është njohur ndërvarësia dhe ndjeshmëria e rezultateve mbi supozimet dhe ndikimi i tyre vlerësohet rregullisht.

7. Banka sigurohet që mangësitë e modeleve (teknikave) dhe mënyrave të përdorura prej saj, që lidhin faktorët e rrezikut me humbjet ose parametrat në rritje të rrezikut, kuptohen, komunikohen qartë dhe merren parasysh gjatë interpretimit të rezultateve. Modelet (teknikat e përdorura nga banka) duhet të marrin në konsideratë edhe ndërveprimin midis kapitalit dhe likuiditetit dhe kostove të financimit, me qëllim shmangien e një nënvlerësimi të rëndësishëm të efektit të një goditjeje. Banka, aty ku është e mundur, krahason rezultatet e qasjeve të ndryshme të modelimit. Lidhjet duhet të bazohen në modele (teknika) të qëndrueshme statistikore. Megjithatë, nëse disponueshmëria ose cilësia e të dhënave, ose thyerjet strukturore në të dhënat historike nuk lejojnë vlerësime kuptimplota, analizat sasiore duhet të mbështeten nga gjykimet cilësore të ekspertëve. Edhe në rastet kur procesi bazë i modelimit është i qëndrueshëm, gjykimi i ekspertëve duhet të luajë një rol të rëndësishëm nëpërmjet sfidimit të rezultateve të modelit.

8. Në rast se banka është pjesë e një grupi të huaj bankar, ajo duhet të kuptojë plotësisht modelet e stress test-eve të krijuara nga banka

mëmë. Nëse banka përdor modelet e bankës mëmë, ajo sigurohet se modelet e përdorura janë të përshtatshme për llojet e rreziqeve ndaj të cilave banka është e ekspozuar, si dhe marrin në konsideratë edhe faktorët makroekonomikë vendas dhe nivelin e detajimit të të dhënave.

Neni 15

Analiza e ndjeshmërisë

1. Banka kryen analiza të ndjeshmërisë në nivel: ekspozimesh individuale, portofolash ose njësisish biznesi, banke dhe për lloje të veçanta rreziku, në përputhje me shkallën e kompleksitetit të saj. Banka vlerëson në çfarë niveli agregimi kanë kuptim dhe janë të realizueshme, analizat e ndjeshmërisë. Përdorimi i gjykimeve të ekspertëve duhet të përshkruhet në detaje, kur është e mundur.

2. Banka identifikon faktorët përkatës të rrezikut në nivele të ndryshme të zbatimit të kërkesave prudenciale dhe midis portofolave, njësisive të biznesit dhe vendndodhjeve gjeografike të ndryshme. Banka siguron që merren në konsideratë të gjitha llojet përkatëse të faktorëve të rrezikut, përfshirë treguesit makroekonomikë dhe makrofinanciarë, aspektet statistikore të parametrave të rrezikut (si për shembull luhatshmëria e probabilitetit të dështimit (PD) dhe faktorët specifikë (si për shembull rreziqet operacionale)).

3. Banka mban një listë të faktorëve të rrezikut që ka identifikuar.

4. Banka plotëson analizat e faktorëve me një rrezik të vetëm, me analiza të faktorëve të thjeshtë me shumë rreziqe, ku supozon një dukuri të kombinuar, pa përcaktuar domosdoshmërih skenarin.

Neni 16

Analiza e skenarëve

1. Banka siguron që analiza e skenarëve është pjesë thelbësore e programit të saj të stress test-eve.

2. Banka, në hartimin e skenarëve të stress test-eve, nuk bazohet vetëm në të dhëna historike, por gjithashtu konsideron edhe skenarë hipotetikë, të bazuar në të dhëna johistorike. Banka siguron që hartimi i skenarëve të jetë i orientuar nga e ardhmja dhe të marrë parasysh ndryshimet sistematike (të



përgjithshme) dhe ndryshimet specifike të bankës, në të tashmen dhe në të ardhmen e parashikueshme. Për këtë qëllim, banka kërkon të dhëna të jashtme nga mjedise të ngjashme të rrezikut, të bankave me modele të ngjashme biznesi.

3. Banka përdor të dhëna të përshtatshme (relevante) dhe të cilat janë të disponueshme. Të dhënat e përshtatshme mund të jenë të brendshme dhe/ose të jashtme dhe, nëse është e mundur, përfshijnë benchmarking dhe udhëzimet/orientimin e mbikëqyrësve.

4. Banka merr në konsideratë një sërë skenarësh, duke përfshirë ngjarje të ndryshme dhe shkallë të ndryshme të ashpërsisë.

5. Banka siguron që skenarët e stress test-eve përmbushin të paktën kërkesat e mëposhtme:

a) adresojnë faktorët kryesorë të rrezikut ndaj të cilëve banka mund të ekspozohet. Në këtë drejtim, rezultatet e marra nga analizat e një faktori të vetëm rreziku, të cilat synojnë të sigurojnë informacione në lidhje me ndjeshmërinë ndaj faktorëve të vetëm të rrezikut, duhet të përdoren për të identifikuar skenarët që përfshijnë një goditje të një grupi të kombinuar faktorësh rreziku, me mundësi të lartë për të ndodhur. Asnjë faktor material i rrezikut nuk duhet të lihet i pastresuar (pagoditur) apo i pakonsideruar;

b) adresojnë dobësitë kryesore specifike të bankës, që rrjedhin nga karakteristikat rajonale dhe sektoriale të saj, si dhe ekspozimet specifike sipas llojit të produktit ose të linjës së biznesit dhe politikat e financimit; rreziqet e përqendrimit dhe të korrelacionit, si brenda të njëjtut lloj rreziku, ashtu edhe midis llojeve të ndryshme të rreziqeve, duhet të identifikohen *a priori*;

c) përfshijnë një përshkrim të qartë/të kuptueshëm të skenarit, duke përshkruar të gjithë faktorët e rëndësishëm të rrezikut, si dhe zhvillimin e tyre (të orientuar nga e ardhmja) në bazë të ngjarjeve të shumëfishta aktivizuese (trigger events) (p.sh. politika monetare, zhvillimet në sektorin financiar, çmimet e mallrave, ngjarjet politike dhe fatkeqësitë natyrore). Banka sigurohet që përshkrimi i skenarit është i besueshëm dhe jo kontradiktor, kur supozohet një lëvizje e njëkohshme e faktorëve të rrezikut dhe reagimi përkatës i pjesëmarrësve të tregut. Kur disa faktorë të rrezikut përjashtohen nga përshkrimi i skenarit,

banka siguron që ky përjashtim të jetë plotësisht i justifikuar dhe i dokumentuar;

d) janë të qartë/të kuptueshëm brenda bankës, në mënyrë që të sigurojnë që faktorët e identifikuar të rrezikut të sillen në përputhje me faktorët e tjerë të rrezikut në një situatë stresi dhe që ato përmbajnë vlerësime dhe supozime të qarta mbi strukturën e varësisë midis faktorëve bazë të rrezikut. Lëvizjet e njëkohshme të faktorëve të rrezikut që duken kontradiktore duhet të shqyrtohen, në mënyrë që të identifikohen lidhje të reja midis faktorëve;

e) marrin parasysh rrishtë dhe më konkretisht, zhvillimet teknologjike ose produktet e sofistikuar financiare, si dhe ndërveprimin e tyre me produktet më tradicionale/ekzistuese; dhe

f) sigurojnë që faktorët e stresuar të rrezikut, përkthehen në parametra të brendshëm të qëndrueshëm të rrezikut, në përputhje me oreksin/tolerancën ndaj rrezikut.

6. Banka përcakton horizontin kohor të stress test-it në përputhje me qëllimin e ushtrimit, karakteristikat e portofolit të bankës, të tilla si maturiteti dhe likuiditeti i pozicioneve të stresuara, kur është e mundur, si dhe profili i rrezikut. Stress test-et e kapitalit dhe të likuiditetit përfshijnë horizonte kohore dhe skenarë të ndryshëm.

7. Banka siguron që:

a) stress test-et marrin parasysh ndërvarësitë dinamike, p.sh. midis rajoneve ekonomike dhe midis sektorëve ekonomikë, duke përfshirë edhe sektorin financiar;

b) skenari i përgjithshëm merr në konsideratë dinamikat sistemike, p.sh. mbyllja e tregjeve të caktuara, ose përqendrimet e rrezikut në një klasë të vetme të aktiveve (p.sh. kreditë hipotekare).

8. Banka bën vlerësime cilësore të efekteve të raundit të dytë ndaj goditjeve, kur është e përshtatshme dhe në veçanti, nëse nuk mund të përcaktohet një vlerësim sasior i qëndrueshëm.

Neni 17

Ashpërsia e skenarëve

1. Banka siguron që stress test-et bazohen në skenarë të ashpër, por të mundshëm për të ndodhur dhe shkalla e ashpërsisë duhet të pasqyrojë qëllimin e stress test-eve. Për këtë qëllim stress test-et duhet të:



a) jenë kuptimplotë, në lidhje me adresimin e rreziqeve përkatëse të bankës, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të bankës në kushte të pafavorshme dhe, në rastin e bankave me rëndësi sistematike, edhe të stabilitetit të sistemit financiar në të gjitha pikat e ciklit të ekonomisë dhe mbi luhatjet e tregut, përfshirë tregjet ku banka siguron financimet; dhe

b) zbatohen në mënyrë të njëjtë në të gjithë bankën, duke pranuar se efekti i skenarëve të njëjtë nuk është domosdoshmërisht i ashpër për të gjitha linjat e biznesit.

2. Banka siguron që shkallë të ndryshme të ashpërsisë të merren parasysh gjatë analizës së ndjeshmërisë dhe analizës së skenarëve, duke përfshirë të paktën një rënie ekonomike të konsiderueshme, për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe për qëllime të planifikimit të kapitalit.

3. Banka siguron që ashpërsia e skenarit caktohet duke marrë parasysh dobësitë specifike të saj, kundrejt një skenari të caktuar, në bazë të modelit të biznesit (p.sh. banka është e ekspozuar ndaj tregjeve ndërkombëtare). Banka zhvillon skenarët e saj dhe nuk bazohet në skenarët e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Banka, gjatë vlerësimit të ashpërsisë së një skenari, duhet të njohë dinamikën e mjediseve të rrezikut dhe, aty ku është e mundur, përvojat e bankave me modele të ngjashme biznesi.

4. Banka siguron që skenarët e saj vlerësojnë ndryshimet absolute ose relative të faktorëve të rrezikut. Në një skenar absolut shkalla e ashpërsisë duhet të përcaktohet nga një ndryshim direkt i faktorit të rrezikut dhe nuk duhet të varet nga niveli aktual. Në një skenar relativ shkalla e ashpërsisë duhet të varet nga niveli aktual dhe situata aktuale ekonomike (p.sh. rritja e PBB-së ulet me 2%; ky është një ndryshim relativ i nivelit absolut). Banka siguron që skenari i zgjedhur të jetë mjaft i ashpër, si në terma relativë, edhe absolutë. Banka shpjegon dhe dokumenton zgjedhjen dhe ndikimin e skenarit në shkallën e ashpërsisë.

5. Banka, për vlerësimin e shkallës së duhur të ashpërsisë së skenarëve, i krahason ato me skenarët e krijuar/hartuar në stress test-in e anasjellë, duke marrë në konsideratë efektet e hartimit të stress test-eve të anasjellë mbi besueshmërinë e skenarit.

Neni 18

Kërkesat për stress test-et e anasjella

1. Banka, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, kryen stress test-et e anasjella si pjesë të programit të stress test-eve, duke përdorur të njëjtat standarde të drejtimit dhe të cilësisë dhe një infrastrukturë efektive, si dhe për të plotësuar llojet e tjera të stress test-eve.

2. Bankat me rëndësi sistematike përdorin teknika më të sofistikuar të stress test-eve të anasjella, ndërsa bankat me rëndësi josistematike përqendrohen më tepër në aspektet cilësore të stress test-eve.

3. Stress test-et e anasjella duhet të përcaktojnë qartë përgjegjësitë dhe burimet e nevojshme dhe duhet të mbështeten nga një infrastrukturë e përshtatshme dhe fleksibël, si dhe nga politika e procedura të shkruara.

4. Stress test-et e anasjella kryhen rregullisht nga të gjitha bankat dhe në të njëjtin nivel zbatimi si procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit (p.sh. në nivel banke/grupi dhe mbulojnë të gjitha llojet përkatëse të rrezikut).

5. Banka përfshin edhe skenarë të identifikuar me anë të stress test-eve të anasjella, për të plotësuar tërësinë e skenarëve të stress test-eve që ajo përdor dhe për qëllime krahasimi, në mënyrë që të vlerësojë ashpërsinë e përgjithshme të tyre, që lejojnë identifikimin e skenarëve të ashpër, por të mundshëm për të ndodhur. Stress test-et e anasjella duhet të përdoren për të përcaktuar ashpërsinë e skenarëve për stress test-et e procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit. Ashpërsia e skenarëve të stress test-eve të anasjella mund të vlerësohet duke e krahasuar, ndër të tjera, me skenarë historikë ose me skenarë të tjerë të Bankës së Shqipërisë dhe të publikuar.

6. Banka, gjatë kryerjes së stress test-eve të anasjella, merr parasysh gjithashtu, nëse dështimi i një ose më shumë prej kundërpasive kryesore të saj ose një çrregullim i konsiderueshëm i tregut që rezulton nga dështimi i një pjesëmarrësi të rëndësishëm tregu (në mënyrë të veçantë ose të kombinuar), do të shkaktonte rezultatin e paracaktuar.



Neni 19

Përdorimi i stress test-eve të anasjella

1. Banka përdor stress test-in e anasjellë si një mjet të rregullt për administrimin e rrezikut, në mënyrë që të përmirësojë njohuritë e saj mbi dobësitë aktuale dhe potenciale, duke ofruar vlerë të shtuar në administrimin e rrezikut të bankës. Parimi i proporcionalitetit zbatohet në të gjitha aspektet e përdorimit të stress test-eve të anasjella. Megjithatë, banka duhet të marrë në konsideratë gjithashtu se rezultati i paracaktuar i stress test-it të anasjellë mund të shkaktohet nga disa rrethana të tjera, të ndryshme nga ato të analizuar në stress test-et.

2. Banka, si pjesë të planifikimit të biznesit dhe administrimit të rrezikut, përdor stress test-et e anasjella, për të kuptuar dobësitë dhe qëndrueshmërinë e modelit dhe strategjive të biznesit, si dhe për të identifikuar rastet/situatat kur banka mund të ndodhet pranë situatës së paaftësisë paguese. Banka duhet të identifikojë masat që sinjalizojnë se kur materializohet një skenar. Për këtë qëllim, banka:

a) identifikon rezultatin e paracaktuar që do të testohet (p.sh. modeli i biznesit bëhet i parealizueshëm/paqëndrueshëm);

b) identifikon rrethanat e mundshme të pafavorshme, të cilat do ta ekspozonin ndaj dobësive të ashpra dhe do të shkaktonin rezultatin e paracaktuar;

c) vlerëson mundësinë që ngjarjet e përfshira në skenarët, të çojnë në rezultatin e paracaktuar, në varësi të madhësisë, natyrës, shkallës, kompleksitetit dhe rrezikut të veprimitarisë së bankës; dhe

d) miraton marrëveshje, procese, sisteme ose masa të tjera efektive, për të parandaluar ose zbutur rreziqet dhe dobësitë e identifikuar.

3. Banka përdor stress test-et e anasjella në planifikim dhe vendimmarrje, si dhe për të sfiduar modelet dhe strategjitë e biznesit, me qëllim identifikimin dhe analizën e faktorëve, të cilët mund të shkaktojnë që modeli i saj i biznesit të bëhet i pazbatueshëm, të tilla si vlerësimi i aftësisë për të gjeneruar të ardhura gjatë muajve në vijim dhe qëndrueshmëria e strategjisë për gjenerimin e të ardhurave për një periudhë më të gjatë, bazuar në planet strategjike dhe parashikimet financiare.

4. Në rastet kur stress test-et e anasjella tregojnë se rreziku i bankës për dështimin e modelit të

biznesit është shumë i lartë dhe jo në përputhje me oreksin/tolerancën ndaj rrezikut, banka merr masa për të parandaluar ose zbutur një rrezik të tillë, duke marrë parasysh edhe kohën e reagimit ndaj këtyre ngjarjeve dhe për zbatimin e masave. Si pjesë të këtyre masave, banka duhet të marrë në konsideratë edhe faktin nëse kërkohen ndryshime në modelin e saj të biznesit. Këto masa, duke përfshirë edhe ndryshimet në planin e biznesit të bankës, duhet të dokumentohen në dokumentin e Procesit të Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (PVBMK-së) të bankës.

5. Banka kryen analiza cilësore për të zhvilluar një përshkrim të mirëpërcaktuar të stress test-eve të anasjella dhe për të kuptuar qartë efektet e raundit të dytë dhe efektet jolineare, duke marrë në konsideratë dinamikat e rreziqeve dhe kombinimet e ndërveprimet ndërmjet rreziqeve, si dhe brenda rreziqeve. Banka, kur zhvillon një përshkrim të mirëpërcaktuar, duhet të marrë parasysh edhe ngjarjet e jashtme, të tilla si ngjarje ekonomike, problematika të industrisë, ngjarje politike, çështje gjyqësore dhe ngjarje natyrore, si dhe faktorë rreziku, të tillë si rreziku operacional, përqendrimet dhe lidhjet (korrelacionet), rreziku reputacional dhe humbja e besimit, si dhe kombinimin e këtyre ngjarjeve dhe faktorëve.

6. Organet drejtuese të bankës përfshihen në diskutimet mbi përgatitjen e përshkrimit të stress test-eve të anasjella, duke marrë në konsideratë edhe dobësitë specifike të bankës dhe efektin e tyre mbi të gjithë bankën.

7. Banka, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, kryen analiza sasiore dhe më të sofistikuara, gjatë përcaktimit të niveleve specifike të humbjeve ose të ndikimeve të tjera negative në kapitalin, likuiditetin (p.sh. aksesit në burimet e financimit, në veçanti për rritjen e kostove të financimit) ose në pozicionin e përgjithshëm financiar të saj. Banka duhet të konsiderojë edhe periudhat e mëparshme gjatë analizave sasiore, për të identifikuar faktorët e rrezikut dhe nivelin e kërkuar të ndryshimeve, të cilat mund të shkaktojnë nivelin e caktuar të humbjes ose ndikimit negativ (p.sh. përcakton nivelin e përshtatshëm të humbjes ose tregues të tjerë me rëndësi, në bilancin e saj, të tillë si normat e kapitalit ose burimet e financimit).

8. Banka njeh dhe dokumenton shkaktarët e rrezikut, linjat kryesore të biznesit, si dhe një



përshkrim të qartë të dobësive dhe skenarëve përkatës (p.sh. mbi supozimet bazë dhe ndjeshmërinë e rezultateve ndaj këtyre supozimeve), që shkaktojnë rezultatet e paracaktuara dhe rrjedhën e ngjarjeve (p.sh. për faktorët më të rëndësishëm mund të krijohet një korrespondencë (*mapping*) me faktorët makroekonomikë, sipas kombinimeve përkatëse për një humbje/kapital të caktuar në një portofol), duke identifikuar edhe dobësitë e fshehura dhe efektet e mbivendosjes.

9. Banka, kur është e përshtatshme, përdor analizën e ndjeshmërisë si një pikënisje për stress test-et e anasjella (p.sh. duke zhvendosur një ose më shumë parametra përkatës në nivele ekstreme, për të arritur rezultatet e paracaktuara). Banka merr në konsideratë analiza të ndryshme të anasjella të ndjeshmërisë për rrezikun e kredisë (p.sh. sa klientë të mëdhenj duhet të falimentojnë në mënyrë që kapitali të mos ketë më mundësi për të absorbuar humbjet), rrezikun e tregut, rrezikun e likuiditetit (p.sh. goditje mbi depozitat me pakicë dhe rrethanat që do të shteronin rezervat e likuiditetit të bankës) dhe rrezikun operacional, si dhe një kombinim të analizave ku të gjithë rreziqet mbulohen në mënyrë të njëkohshme.

10. Banka, pa rënë ndesh me kërkesat e pikës 9 të këtij neni, nuk duhet të mbështetet vetëm në analizën e ndjeshmërisë për të identifikuar skenarët e përshtatshëm për stress test-in e anasjellë. Analizat dhe vlerësimet cilësore, të kombinuara me gjykimet e ekspertëve nga fusha të ndryshme të biznesit, duhet të orientojnë identifikimin e skenarëve përkatës.

11. Banka përdor stress test-et e anasjella si një mjet për të njohur skenarët, që përfshijnë kombinime të goditjeve të kapitalit (mjaftueshmërisë së kapitalit) dhe të likuiditetit, në rastet kur modeli i stress test-it mund të mos arrijë të identifikojë aspekte komplekse nga situata reale. Banka përdor stress test-et e anasjella, në mënyrë që të sfidojë planifikimet e kapitalit dhe të likuiditetit. Aty ku është e përshtatshme, banka identifikon dhe analizon situatat që mund të përkeqësojnë një ngjarje të stresit të likuiditetit dhe ta transformojnë atë në një ngjarje stresi të kapitalit (mjaftueshmërisë së kapitalit) dhe anasjellës, dhe në fund të shkaktojnë dështimin e biznesit. Banka zbaton stress test-in e anasjellë në mënyrë të integruar, për rreziqet ndaj kapitalit ose likuiditetit,

me qëllim përmirësimin e njohjes dhe administrimin e rreziqeve të lidhura, në situata ekstreme.

Neni 20

Masat e rimëkëmbjes dhe planet e rimëkëmbjes

1. Banka harton skenarë të përkeqësimit të situatës makroekonomike dhe financiare, me ashpërsi të ndryshme (që përfshijnë ngjarje sistemike, ngjarje specifike të vetë bankës dhe të grupit bankar, ku banka bën pjesë), të cilët i përdor në planet e rimëkëmbjes sipas kërkesave të rregullores “Mbi planet e rimëkëmbjes së bankave”.

2. Banka përdor stress test-e të anasjella specifike, për të hartuar skenarë që parashikojnë ta çojnë bankën pranë një situatë të paaftësisë paguese (*near-default*) dhe si një e dhënë për të informuar dhe për të testuar efektivitetin e masave të saj të rimëkëmbjes dhe të planit të rimëkëmbjes, si dhe analizon ndjeshmëritë rreth supozimeve përkatëse.

3. Skenarë të tillë që parashikojnë ta çojnë bankën pranë një situatë të paaftësisë paguese (*near-default*), duhet të identifikojnë dhe të përshkruajnë pikën/situatën që do të çonte modelin e biznesit të bankës apo grupit ku ajo bën pjesë, që të bëhet i paralizueshëm/i paqëndrueshëm, nëse nuk do të zbatoheshin me sukses masat e rimëkëmbjes.

4. Skenarët e përdorur nga banka duhet të lejojnë vlerësimin e rezultateve dhe përshtatshmërinë e të gjitha masave të rimëkëmbjes në dispozicion të saj.

5. Përshkrimi i skenarëve të rimëkëmbjes duhet të ndihmojë në përcaktimin e masave të rimëkëmbjes që janë testuar në skenarë të veçantë të stresit. Përshkrimi duhet të jetë i detajuar në mënyrë të mjaftueshme, duke paraqitur një sërë supozimesh sasiore dhe një përshkrim cilësor, për të përcaktuar nëse skenari është i përshtatshëm për bankën dhe nivelin e ashpërsisë së tij. Ngjarjet përshkruhen në një rrjedhë logjike dhe supozimet që qëndrojnë në bazë të shkaktarëve kryesorë (p.sh. të ardhurat neto, aktivet e ponderuara me rrezikun, kapitali), përcaktohen në mënyrë të qartë.

6. Skenarët marrin në konsideratë edhe një vlerësim të mundshëm të efekteve ndërvepruese, kur masa të ndryshme të planit të rimëkëmbjes zbatohen njëkohësisht në të njëjtin skenar. Skenarët gjithashtu duhet të sqarojnë se si pritët të ndodhin



ngjarjet, duke paraqitur edhe një afat kohor të përshtatshëm, i cili qartëson momentin kur duhet të ndërmerren veprime të caktuara. Qëllimi i këtij ushtrimi është të provojë efektivitetin e masave të rimëkëmbjes së bankës në rivendosjen e qëndrueshmërisë dhe të pozicionit financiar, kur banka gjendet në një situatë të rënduar stresi.

7. Stress test-et për qëllime të procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe për qëllime të planeve të rimëkëmbjes, për shkak të objektivave të ndryshme që kanë, nuk duhet të jenë të ndërlidhur, por të krahasueshëm me njëri-tjetrin.

8. Banka përdor stress test-et e anasjella, për të identifikuar faktorët e rrezikut dhe për të kuptuar dhe përshkruar më tej skenarët që do ta çonin bankën pranë një situatë të paaftësisë pague (near-default), duke vlerësuar masat efektive të rimëkëmbjes që mund të zbatohen në mënyrë të besueshme, paraprakisht ose në varësi të zhvillimeve/ndodhjes së skenarëve ose faktorëve të rrezikut.

9. Stress test-i i anasjellë duhet të kontribuojë në skenarët e planit të rimëkëmbjes, duke përdorur një përshkrim dinamik dhe sasior të skenarëve, i cili përfshin:

a) ngjarjet aktivizuese të rimëkëmbjes (d.m.th. në cilën pikë banka do të ndërmarrë veprime të rimëkëmbjes në skenarin hipotetik);

b) masat e nevojshme të rimëkëmbjes dhe efektivitetin e tyre të pritshëm, duke përfshirë metodën e vlerësimit të efektivitetit (d.m.th. treguesit që duhet të monitorohen për të arritur në përfundimin se nuk kërkohet asnjë veprim i mëtejshëm);

c) kohën e duhur dhe procesin e nevojshëm, për të ndërmarrë ato masa të rimëkëmbjes;

d) në rast të vazhdimësisë së stresit, masat e mundshme shtesë të rimëkëmbjes, të cilat duhet të marrin në konsideratë edhe rreziqet e mbetura.

KREU V STRESS TEST-et E RREZIQEVE INDIVIDUALE

Neni 21

Fushat e rreziqeve individuale

1. Banka siguron që stress test-et e rreziqeve individuale kryhen në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Banka, kur është e mundur, gjatë kryerjes së stress test-eve të rreziqeve individuale, merr parasysh edhe efektet e raundit të dytë në rreziqet individuale.

NËNKREU I RREZIKU I KREDISË

Neni 22

Rreziku i kredisë dhe rreziku i kredisë së kundërpartisë, përfshirë rrezikun e migrimit dhe rrezikun e dështimit

1. Banka identifikon dhe vlerëson faktorët specifikë të rrezikut dhe përcakton paraprakisht se si këta faktorë mund të ndikojnë në të ardhurat e saj dhe në kërkesën për kapital. Banka identifikon dhe vlerëson faktorët specifikë të rrezikut, sipas klasave të ekspozimeve (p.sh. faktorët që lidhen me kreditë hipotekare mund të jenë të ndryshëm nga ata që lidhen me klasat e ekspozimeve ndaj shoqërive tregtare (korporatave)).

2. Banka, gjatë kryerjes së stress test-eve për ekspozimet e saj ndaj rrezikut të kredisë, aty ku është e mundur, analizon të paktën:

a) aftësinë e huamarrësve për të shlyer detyrimet e tyre, p.sh. probabilitetin e dështimit (PD);

b) normën e rikuperimit, në rast dështimi të një huamarrësi, përfshirë edhe përkeqësimin e vlerës së kolateralit ose të aftësisë pague të garantuesit, p.sh. humbje në rast dështimi (LGD);

c) madhësinë dhe dinamikën e ekspozimit të kredisë, duke përfshirë edhe efektin e angazhimeve të papërdorura/ të patërhequra nga huamarrësit, p.sh. ekspozimi në dështim (EAD).

3. Banka siguron që stress test-et e rrezikut të kredisë në nivel banke/grupi, përfshijnë të gjitha pozicionet e saj në librin e bankës dhe në librin e tregtueshëm, si dhe pozicionet e mbrojtjes dhe ekspozimet ndaj kundërpartive qendrore.

4. Banka vlerëson rrezikun e kredisë, për nivele të ndryshme të goditjes (skenar bazë, skenar i rënduar etj.), duke u nisur nga analizat e thjeshta të ndjeshmërisë, deri në stress test-et në nivel banke ose në nivel grupi, për skenarët e mëposhtëm:

a) skenarë të goditjeve të tregut (p.sh. ngadalësimi i ndjeshëm i ekonomisë, që ndikon në cilësinë e portofolit për të gjithë kreditorët);

b) skenarë të goditjeve ndaj kundërpartive të caktuara dhe të goditjeve specifike (idiosyncratic)



(p.sh. falimentimi i kreditorit më të madh të bankës);

c) skenarë të goditjeve ndaj sektorëve dhe zonave gjeografike specifike;

d) kombinimi i skenarëve të lartpërmendur.

5. Banka konsideron faktorët e rrezikut për analizat e ndjeshmërisë, të cilat nga ana e tyre duhet të ofrojnë informacion sasior për hartimin e skenarëve.

6. Banka, kur zbaton skenarët e stresit, përcakton horizonte të ndryshme kohore, të cilët mund të luhaten nga periudha afatshkurta, deri në afate më të gjata.

7. Banka, në rastet kur streson/godet vlerat e kolateralit financiar, përfshirë edhe vlerën e aktiveve të marra në pronësi nga proceset gjyqësore për ekzekutimin e kolateraleve të kredive me probleme, duhet të identifikojë kushtet që do të ndikojnë negativisht në vlerën e realizueshme të kolateralit, duke përfshirë përqësimin e cilësisë së kredisë të emetuesit të kolateralit ose mungesën e likuiditetit të tregut (rreziku i likuiditetit të tregut).

8. Banka, në hartimin e skenarëve, konsideron ndikimin e ngjarjeve të stresit, edhe mbi llojet e tjera të rrezikut, p.sh. rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e tregut, si dhe mundësinë e përhapjes/përçimit të rrezikut në banka të tjera.

9. Banka konsideron, aty ku është e mundur, parametrat në vijim: probabilitetin e dështimit (PD), humbjen në rast dështimi (LGD), ekspozimin në dështim (EAD), humbjen e pritshme (EL) dhe vlerën e ekspozimeve ndaj rrezikut, si dhe ndikimin në humbjet nga kreditë dhe në kërkesat për kapital.

10. Banka, për vlerësimin e humbjeve të ardhshme sipas stress test-eve, mbështetet (kur është e përshtatshme) në parametrat e rrezikut të kredisë, të ndryshme nga ato që zbaton në llogaritjen e kërkesës për kapital, të cilat zakonisht për probabilitetin e dështimit (PD) janë parametra “përgjatë ciklit” (*through the cycle*) ose parametra hibridë (kombinim i parametrave “përgjatë ciklit” (*through the cycle*) dhe parametra “në një moment kohor” (*point in time*)), si dhe në kushtet e rënies ekonomike, për humbjen në rast dështimi (LGD). Në veçanti, aty ku është e përshtatshme, banka, për qëllime të vlerësimit të humbjeve nga kreditë, duhet të zbatojë vlerësime bazuar në parametra “në një moment kohor” (*point in time*), në përputhje me ashpërsinë e skenarit.

11. Banka, për llogaritjen e ekspozimit në dështim (EAD), aplikon edhe përqindjet për zërat jashtë bilancit, të parashikuara në nenin 9 të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” dhe në veçanti, konsideron edhe parashikimet sipas kushteve të punës të bankës për të anuluar në mënyrë të njëanshme shumat e papërdorura të angazhimeve të kredisë, veçanërisht në situata stresi.

12. Banka, kur vlerëson rrezikun e saj ndaj kundërpartive me ekspozime të rëndësishme (materiale), merr në konsideratë edhe përqendrimet e rreziqeve dhe nuk duhet të supozojë ekzistencën e kolateralit ose marrëveshjeve të rivendosjes së marzheve në mënyrë të vazhdueshme, të cilat mund të mos jenë të disponueshme në rastet e goditjeve të forta të tregut. Banka identifikon në mënyrë të përshtatshme, rreziqe të tilla të korreluara.

13. Banka pasqyron rezultatet e stress test-eve të rrezikut të kredisë dhe rrezikut të kredisë së kundërpartisë, si rritje në aktivet e ponderuara me rrezikun, rritje në kreditë me probleme dhe si rënie në të ardhurat e bankës. Rritja në aktivet e ponderuara me rrezikun do të shkactohej si rezultat i migrimit të ekspozimit në një kategori më të ulët të klasifikimit të kredisë. Rritja në kreditë me probleme do të pasqyrojë rritjen e rrezikut të dështimit. Rënia e të ardhurave vjen si rezultat i rritjes së fondeve rezervë për kreditë në ndjekje dhe kreditë me probleme. Banka, duke u mbështetur në metodologjitë e matjes së humbjeve së pritshme për krijimin e fondeve rezervë sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, gjatë analizave të stress test-eve, duhet të përfshijë në llogaritjen e rritjes së fondeve rezervë, rritjen e probabilitetit të dështimit (PD), të humbjes në rast dështimi (LGD) dhe të ekspozimit në dështim (EAD). Nëse është e mundur, këto parametra duhet të përfshihen edhe në llogaritjen e aktiveve të ponderuara me rrezikun në kushte stresi. Rezultati përfundimtar i rritjes së aktiveve të ponderuara me rrezikun dhe i rritjes së fondeve rezervë duhet të merret parasysh në përllogaritjen e raporteve të kapitalit në situata stresi (raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë, raporti i kapitalit të nivelit të parë dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit)¹.

¹ Banka e llogarit ndikimin në raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit, vetëm një herë për të gjitha



14. Bankat sistemike krijojnë sisteme të brendshme të vlerësimit të rrezikut të kredisë, për të mundësuar kryerjen e stress test-eve efektive për portofolat e kredisë.

Neni 23 Titullzimi

1. Banka merr në konsideratë rreziqet e titullzimit që lindin/rrjedhin nga produktet e strukturuar të kredisë, zakonisht të krijuara nga transferimi i fluksit të parasë nga një grup aktivesh, në segmente rreziku (transhe) të ndryshme ose në *asset-backed securities*.

2. Banka siguron që stress test-i i aktiveve të titullzuara adreson edhe rrezikun e kredisë të grupit të ekspozimeve në të cilën mbështetet titullzimi, duke përfshirë rrezikun e dështimit dhe ndryshimin e vlerave të kolateralit. Banka merr parasysh të gjithë informacionin përkatës në lidhje me strukturën specifike të çdo titullzimi, siç është prioriteti i segmentit të rrezikut (transhit), cilësia e segmentit, përmirësimet e cilësisë së kredisë dhe shkalla e detajimit, e shprehur në numrin efektiv të ekspozimeve.

3. Skenarët duhet të marrin parasysh edhe dështimin e një ose më shumë kundërpartive kontraktuese të përfshira në strukturën e titullzimit, veçanërisht të atyre që veprojnë si garantues të disa segmenteve të caktuara të rrezikut.

Neni 24 Rreziku i vendit

1. Banka kryen analiza të stress test-eve për ekspozimet e saj ndaj rrezikut të vendit, me qëllim monitorimin e rreziqeve aktuale dhe të ardhshme, që rrjedhin nga ekspozimet e rëndësishme të bankës jashtë vendit, ose nga ushtrimi i veprimtarisë jashtë vendit, nëpërmjet filialeve/degëve të saj.

2. Stress test-et përfshijnë vlerësimin e ndikimit të ngjarjeve të ndryshme të rrezikut të vendit, mbi aktivet dhe pasivet e bankës, si dhe mbi zërat jashtë bilancit.

rreziqet së bashku, duke marrë parasysh ndikimin në aktivet e ponderuara me rrezikun dhe të ardhurat, nga goditjet ndaj faktorëve individualë të rrezikut.

Faqe | 11056

3. Banka merr parasysh në skenarët e stress test-eve minimalisht edhe ngjarjet e mëposhtme:

a) qeveria e vendit të huaj nuk ka kapacitetin apo vullnetin për të ripaguar detyrimet e saj direkte apo indirekte (garancitë e dhëna) në valutë të huaj;

b) huamarrësi nuk është në gjendje të konvertojë monedhën vendase me një monedhë të huaj, për shkak të kufizimeve të vendosura nga qeveria e vendit të huaj për konvertimin e monedhës ose transferimin e lirë të kapitalit, duke shkaktuar vonesa në ripagimin e detyrimeve të tij në valutë;

c) zhvillimet e pafavorshme në një vend, mund të shkaktojnë përkeqësimin e cilësisë së kredisë të atij vendi, por edhe të vendeve të tjera të rajonit;

d) aftësia paguese e një huamarrësi vendas, lidhet negativisht me zhvillimet në një vend të huaj, ku huamarrësi ka interesa biznesi;

e) huamarrësi mund të ndikohet nga politikat ekonomike të qeverisë së vendit të huaj, p.sh. taksa apo norma interesi më të larta, të cilat do të përkeqësonin aftësinë e tij paguese;

f) shkallën e përqendrimit sipas të gjitha llojeve të ekspozimeve ndaj rrezikut të vendit, në përpjesëtim me portofolin e kredisë së bankës.

4. Banka pasqyron rezultatet e stress test-eve të rrezikut të vendit, si rritje në peshat e rrezikut për ekspozimet përkatëse dhe rritje në fondet rezervë për rrezikun e vendit, sipas rregullave të brendshme të bankës për krijimin e fondeve rezervë.

Neni 25 Ekspozimet e pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

1. Banka, gjatë kryerjes së stress test-eve, merr në konsideratë edhe rrezikun shtesë që rrjedh nga ekspozimet e kredimarrësve të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit.

2. Banka merr parasysh që rreziku i huadhënies në monedhë të huaj:

a) mund të lindë nga pamundësia e kredimarrësve të ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit (p.sh. kredimarrësit e portofolave me pakicë ose ndërmarrjet e vogla e të mesme (SME)), për të shlyer detyrimet e shprehura në një monedhë të ndryshme nga monedha në të cilën gjenerojnë të ardhurat;

b) lidhet me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e tregut, të lidhur me kursin e këmbimit;



c) karakterizohet nga marrëdhëniet jolineare të komponentëve të rrezikut të kredisë dhe të rrezikut të tregut; dhe

d) ndikohet nga rreziku i përgjithshëm i kursit të këmbimit.

3. Programi i stress test-eve duhet të marrë në konsideratë edhe nivelin e ekspozimeve të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, ndikimin e luhatjeve në kursin e këmbimit, aftësinë e huamarrësit për t'i bërë ballë goditjeve të kursit të këmbimit dhe rritjen e probabilitetit të mospagimit të këtyre huamarrësve, që rrjedh nga këto goditje.

4. Banka, në programet e stress test-eve, merr parasysh rrezikun e kreditimit në monedhë të huaj, që ndikon në lehtësirat e kredisë në anën e aktivitetit të bilancit, si dhe burimet e shumta të rrezikut, duke konsideruar që pamundësia e huamarrësit për të shlyer detyrimin e tij mund të burojë nga:

a) rreziqet që lidhen me burimin e brendshëm të të ardhurave të huamarrësit;

b) rreziqet që lidhen me situatën ekonomike të vendit në të cilin është emetuar monedha; dhe

c) rreziku i kursit të këmbimit.

5. Banka merr në konsideratë, gjatë hartimit ose zbatimit të skenarëve të stress test-it, që impakti i rrezikut të kredidhënies në monedhë të huaj mund të vijë si nga rritja e tepricës së kredisë dhe flukseve të pagesave për shlyerjen e detyrimit, ashtu edhe nga rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me vlerën e kolateraleve/garancive të shprehura në monedhën vendase.

6. Banka zhvillon skenarë të stresit, duke ndryshuar parametra të ndryshëm, për të parashikuar ecurinë e portofolit të kredisë në monedhë të huaj, në raste të ndryshme, si:

a) duke supozuar vlerësimin e kursit të këmbimit të monedhës së huaj, me një përqindje të paracaktuar;

b) duke supozuar ndryshimin e normës së interesit të kredisë në monedhë të huaj me një goditje (pikë përqindje) të paracaktuar; ose

c) kombinimin e të dy skenarëve të mësipërm.

7. Banka, me qëllim që të vlerësojë dobësitë potenciale, duhet të jetë në gjendje të provojë humbje shtesë të rrezikut të kredisë që rrjedhin nga rreziku i kreditimit në monedhë të huaj, të ndara nga humbjet e rrezikut të kredisë dhe shumat e ekspozimit me rrezik që rezultojnë nga ndikimi i skenarit mbi faktorët e rrezikut të kredisë.

8. Banka, kur kryen stress test-et e rrezikut të kreditimit në monedhë të huaj, merr parasysh të paktën:

a) regjimin e kursit të këmbimit dhe mënyrën se si ky regjim mund të ndikojë në ecurinë e kursit të këmbimit, midis monedhës vendase dhe monedhave të huaja;

b) ndikimin e ndjeshmërisë së lëvizjeve të kursit të këmbimit, në vlerësimin e cilësisë së kredisë së huamarrësve;

c) përqendrimin e mundshëm të kreditimit në një monedhë të vetme apo në një numër të kufizuar monedhash të huaja, të cilat shfaqin korrelacion të lartë midis tyre;

d) përqendrimin e mundshëm të kreditimit në sektorë specifikë të ekonomisë, në monedhën e vendit, që kanë veprimtari kryesore në vende apo tregje të huaja, si dhe ecurinë përkatëse të këtyre sektorëve të lidhur me monedhat e huaja.

9. Banka pasqyron rezultatet e stress test-eve, si rritje në peshat e rrezikut për portofolat e kredive në monedhë të huaj, rritje e mundësisë së shndërrimit të kredive të këtyre portofolave në kredi me probleme dhe për rrjedhojë, në kërkesa më të larta për fonde rezervë.

Neni 26

Ekspozimet e pambrojtura ndaj rrezikut të normës së interesit

1. Banka përfshin në programin e stress test-eve, edhe rrezikun shtesë që rrjedh nga ekspozimet e pambrojtura nga rreziku i normës së interesit, duke vlerësuar ndikimin që mund të ketë rritja e normave të interesit, në përkeqësimin e aftësisë paguese të kundërpartisë.

2. Banka, gjatë kryerjes së stress test-eve për ekspozimet e pambrojtura nga rreziku i normës së interesit, veçanërisht për ekspozimet brenda vendit, kur është e mundur, merr në konsideratë ndikimin e rritjes së normave të interesit në ekonominë e vendit, dhe veçanërisht në sektorin e ekonomisë ku kundërpartia është e ekspozuar, me qëllim rivlerësimin e pozicionit të kundërpartisë në treg e rrjedhimisht, edhe pozicionit financiar të saj.

3. Banka merr parasysh që rreziku indirekt i kredisë me burim normat e interesit, mund të materializohet ndaj ekspozimeve të cilat kanë një normë interesi të ndryshueshme dhe janë të pambrojtura nëpërmjet një produkti (instrumenti)



derivativ, kryesisht në segmentin e kredive apo instrumenteve të tjera financiare, me maturitet të mbetur afatmesëm dhe afatgjatë.

4. Banka merr në konsideratë, gjatë hartimit të skenarëve të stress test-it, që rreziku indirekt i kredisë me burim normën e interesit, mund të shkaktohet si nga rritja e flukseve të pagesave për shlyerjen e detyrimit, ashtu edhe nga rritja e tepricës së kredisë krahasuar me vlerën e garancisë.

5. Banka zhvillon skenarë të stresit për rrezikun indirekt të kredisë me burim normat e interesit, duke pasqyruar ndikimin e ndryshimit të mundshëm të normave të interesit në parametra të ndryshëm financiarë të kundërpartive, në nivel individual, grupi klientësh ose portofoli, të tillë si raporti i vlerës së këstit ndaj të ardhurave, për të parashikuar ndikimin negativ në cilësinë e portofolit të kredisë apo instrumenteve të tjera financiare, objekt i këtij rreziku.

Neni 27

Rreziku i përqendrimit të kredisë

1. Stress test-et duhet të shërbejnë si një mjet kyç në identifikimin e rrezikut të përqendrimit, pasi i mundësojnë bankës identifikimin e ndërlidhjeve midis ekspozimeve, të cilat mund të bëhen të dukshme vetëm në kushtet e stresit, si dhe përqendrimet e fshehura.

2. Banka, gjatë vlerësimit të këtij rreziku në programin e stress test-eve, merr parasysh rrezikun e kredisë për çdo ekspozim, si dhe burimet shtesë të rrezikut që rrjedhin nga sjellja e ngjashme e disa ekspozimeve të caktuara (që kanë korrelacion më të lartë). Këto burime shtesë të rrezikut që analizohen, përfshijnë elementet e mëposhtme:

a) përqendrimet ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, siç përcaktohen në rregulloren për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave;

b) përqendrimet ndaj klientëve me probleme;

c) përqendrimet gjeografike;

d) përqendrimet sektoriale;

e) përqendrimet ndaj ekspozimeve në monedhë të huaj;

f) përqendrimet sipas produkteve;

g) përqendrimet sipas kolateraleve/garancive;

h) etj.

3. Banka, gjatë kryerjes së stress test-eve, veçanërisht në nivel banke, duke përfshirë edhe në

nivel grupi, vlerëson rrezikun e përqendrimit duke marrë parasysh ekspozimet brenda dhe jashtë bilancit, si edhe pozicionet në librin e bankës dhe në pozicionet e mbrojtjes.

4. Stress test-et duhet të marrin parasysh ndryshimet që mund të ndodhin në mjedisin e biznesit, që do të çonin në materializimin e rrezikut të përqendrimit. Në veçanti, stress test-et marrin në konsideratë ndryshime të pazakonshme, por të besueshme/të mundshme për të ndodhur, në lidhjen korrelative midis llojeve të ndryshme të faktorëve të rrezikut, si dhe ndryshime ekstreme dhe të pazakonshme në parametrat e rrezikut, duke shkuar përtej faktorëve të vetëm të rrezikut, për të parë skenarët që marrin parasysh ndërlidhjen e faktorëve të rrezikut, jo vetëm në raundin e parë, por edhe në raundin e dytë.

5. Banka, kur është e përshtatshme, përfshin në stress test-e, mënyrën në të cilën ekspozimet e përqendruara veprojnë në përgjigje të faktorëve të njëjtë të rrezikut, duke përfshirë rrezikun e humbjeve të mëdha afatshkurtra, si rezultat i ekspozimeve të përqendruara në portofolin me pakicë dhe të shoqërive tregtare (korporatave), ose në subjekte të ndryshme të një grupi.

6. Banka, për të vlerësuar nivelin ex-ante të rrezikut të përqendrimit dhe/ose ndikimin e skenarit në nivelin e përqendrimit, kur është e përshtatshme, merr në konsideratë, matës më kompleksë apo më pak kompleksë (si për shembull Indeksin e Herfindahl-Hirschman (HHI) dhe koeficientët Gini).

7. Banka merr në konsideratë ekzistencën e mundshme të mbivendosjeve ndërmjet burimeve të ndryshme të përqendrimit.

8. Stress test-et e rrezikut të përqendrimit të kredisë përfshijnë:

a) matjen e rritjes së rrezikut të përqendrimit të kredisë, për një portofol kredie të diversifikuar në një mënyrë tjetër; ose

b) rritjen e rrezikut të dështimit ose të rikuperimit në një portofol të përqendruar, në situatë stresi.

9. Për qëllime të pikës 8, shkronja “a” e këtij neni, disa nga skenarët e përshtatshëm për matjen e rritjes së rrezikut të përqendrimit të kredisë, për një portofol kredie të diversifikuar në një mënyrë tjetër mund të jenë:

a) dështime të njëkohshme të disa huamarrësve të mëdhenj;



b) rritje në dështimet e ndërlidhura midis disa sektorëve, të cilët në kohë normale (jo situata stresi) duken të diversifikuar/të pakorreluar;

c) dështim i të gjithë huamarrësve të mëdhenj, që ndodhen në klasën më të ulët të klasifikimit të kredisë (të brendshëm apo të jashtëm) të bankës;

d) dështime të njëkohshme të disa ekspozimeve të mëdha në një vend të caktuar.

10. Banka, për matjen e rrezikut të përqendrimit sipas skenarëve të parashikuar në pikën 9 të këtij neni, në rastet kur përdor indeksin Herfindahl Hirschman (HHI), e rillogarit indeksin, duke trajtuar ekspozimet që supozohen se do të dështojnë, si një ekspozim i vetëm ose si një ekspozim ndaj një sektori. Vlera e re e indeksit HHI (ose e matësve të tjerë të përqendrimit) mund të përdoret për të vlerësuar kërkesat shtesë për kapital, në situata stresi. Përllogaritja e vlerave të reja të indeksit duhet të pasqyrojë edhe rritjen e korrelacioneve (ndërlidhjeve) në situata stresi.

11. Për qëllime të pikës 8, shkronja “b” të këtij neni, disa nga skenarët e përshtatshëm për matjen e rritjes së rrezikut të dështimit ose të rikuperimit në një portofol të përqendruar, në situatë stresi, mund të jenë:

a) rritja në normën e dështimit në një sektor të veçantë, për shkak të një goditjeje makroekonomike;

b) rritja në raportet e vlerës së ekspozimit të siguruar me pasuri të paluajtshme rezidenciale ose tregtare, ndaj vlerës së pasurisë së paluajtshme, si rezultat i rënies së vlerave të pasurive të paluajtshme (kolateraleve);

12. Banka merr në konsideratë efektin e skenarëve të parashikuar në pikën 11 të këtij neni, të cilët mund të përkthehen në kërkesa shtesë për kapital, duke rritur peshat e rrezikut për të reflektuar probabilitetet e dështimit dhe humbjet në rast dështimi, më të larta, të portofolave të veçantë të përqendruar në situatë stresi. Për më tepër, ndikimi i situatës së stresit në të ardhurat e bankës, vlerësohet duke llogaritur rritjen e fondeve rezervë që rrjedhin nga rritja e nivelit të kredive me probleme, sipas skenarëve. Banka merr në konsideratë se niveli i kapitalit do të ndikohet nga rritja e peshave të rrezikut, si dhe nga rënia e të ardhurave, dhe rezultati i stress test-it duhet t'i pasqyrojë të dyja rastet.

NËNKREU II RREZIQE TË TJERA

Neni 28

Rreziku i tregut

1. Banka merr në konsideratë rrezikun e tregut dhe veçanërisht rreziqet që rrjedhin nga humbjet në vlerën e pozicioneve, që shkaktohen nga ndryshimet e pafavorshme në çmimet e tregut të ekspozimeve brenda dhe jashtë bilancit.

2. Banka kryen stress test-e për pozicionet e saj në instrumentet financiare, në portofolin e tregtueshëm dhe të vendosjes, duke përfshirë pozicionet/instrumentet e titullzuara dhe obligacionet e garantuara. Këto stress test-e duhet të kryhen si pjesë e stress test-eve në nivel banke, si dhe për qëllime të administrimit dhe përllogaritjes së rrezikut të tregut.

3. Banka zbaton një sërë skenarësh të rënduar, por të besueshëm/të mundshëm për të ndodhur, për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni (p.sh. mungesa e likuiditetit në tregje ose dështime të pjesëmarrësve të mëdhenj në tregje). Banka, kur është e përshtatshme, merr parasysh varësinë dhe korrelacionet midis tregjeve të ndryshme dhe për pasojë, edhe ndryshimet e pafavorshme në këto korrelacione.

4. Banka, gjatë kalibrimin të këtyre stress test-eve, merr parasysh minimalisht natyrën dhe karakteristikat e portofolave dhe instrumenteve financiare përkatës, vëllimin e tregjeve në të cilët tregtohen këto instrumente, strategjinë e tregtimit të tyre, si dhe mundësinë, kostot dhe kohën që do të nevojitet për të mbrojtur ose administruar rreziqet, në kushte të situatave të rënduara të tregut.

5. Banka siguron që stress test-et rishikohen në mënyrë të vazhdueshme, për t'u përshtatur me ndryshimet e elementeve të parashikuara në pikën 4 të këtij neni.

6. Banka, kur vlerëson se metoda e përdorur prej saj nënvlerëson rrezikun e matur (p.sh. përdor një metodë që synon të shpjegojë sjelljen e çmimit sipas shpërndarjes normale), duhet të mbështetet mbi një metodë më të përshtatshme (p.sh. shpërndarja historike), për të identifikuar masën e rrezikut të nënvlerësuar, ose të përdorë skenarë të rënduar hipotetikë që parashikojnë ngjarje përtej niveleve teorike (të sugjeruara nga modeli) të besimit.



7. Banka harton një plan masash, së bashku me kufijtë dhe veprime të tjera të mundshme, të ndërmarra për të ulur rreziqet dhe për të ruajtur nivelin e kërkuar të kapitalit. Në veçanti, kur është e përshtatshme, banka merr parasysh kufijtë e vendosur prej saj, për rrezikun e kursit të këmbimit, normës së interesit, çmimeve të titujve të kapitalit dhe të çmimeve të mallrave, në lidhje me rezultatet e llogaritjeve të stress test-eve.

8. Banka, gjatë kryerjes së stress test-eve, veçanërisht në nivel banke, duke përfshirë edhe në nivel grupi, vlerëson rrezikun e përqendrimit duke marrë parasysh ekspozimet brenda dhe jashtë bilancit.

9. Banka konsideron ndikimin në librin e tregtueshëm, të ekspozimit ndaj faktorëve të ndryshëm të rrezikut.

10. Banka i mat rezultatet e stress test-it në terma të humbjeve të përcaktuara të akumuluar në portofol, ose të gërryerjes së fitimeve të përcaktuara, nëse ka, të pranishme në klasat e ndryshme të aktiveve, ose si një kombinim i të dyjave. Këto humbje duhet të merren parasysh gjatë parashikimeve/projektimeve të raporteve të kapitalit në situata stresi.

Neni 29

Rreziku i normës së interesit në librin e bankës

1. Stress test-et duhet të mbështesin dhe të jenë pjesë përbërëse e sistemit të brendshëm të administrimit të rrezikut të normave të interesit në librin e bankës.

2. Skenarët e normave të interesit të përdorura për qëllime të stress test-eve të rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, duhet të jenë të përshtatshëm për të identifikuar të gjitha rreziqet materiale të normës së interesit, të tillë si: rrezikun e rëqimit, rrezikun e kurbës së kthimit (yield-eve), rrezikun bazë dhe rrezikun e opsioneve.

3. Banka siguron që stress test-et e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, nuk bazohen vetëm në një zhvendosje të thjeshtë paralele, por në analizën e skenarëve të merren në konsideratë edhe lëvizjet dhe ndryshimet në formën e kurbës së kthimit (yield-it), mospërputhja e normave referencë të interesit (rreziku bazë), si dhe rreziqet nga shlyerjet e parakohshme, të përfshira në kontrata nëpërmjet një opsioni, në mënyrë që të identifikohen të gjitha burimet e rrezikut.

4. Banka i mat rezultatet e stress test-eve në terma të rënies së vlerës së kapitalit të brendshëm dhe të të ardhurave neto nga interesat. Banka, në rastet e rënies së vlerës së kapitalit të brendshëm ose të të ardhurave neto nga interesat, cilado është më e larta, pasqyron efektin në raportet e parashikuara të kapitalit në situata stresi.

Neni 30

Rreziku operacional

1. Banka merr në konsideratë se parametrat përkatës të rrezikut që lidhen me rrezikun operacional, mund të rrjedhin nga pamjaftueshmëria ose dështimi i proceseve të brendshme, njerëzve, sistemeve, përfshirë rreziqet ligjore, ose nga ngjarje të jashtme dhe që mund të ndikojnë në të gjitha produktet dhe veprimtaritë brenda bankës.

2. Banka, për të goditur/stresuar parametrat përkatës të rrezikut, përdor ngjarjet me natyrë operacionale, të regjistruara sipas politikave të saj të brendshme, pavarësisht nëse ka një efekt të materializuar ose jo, në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Banka, meqenëse humbjet operacionale mund të shkaktojnë efekte të tjera të raundit të dytë (p.sh. rrezik reputacional), në mënyrë që të merren në konsideratë edhe këto efekte, e integron tërësisht programin e stress test-eve të rrezikut operacional, në stress test-et e përgjithshme (në nivel banke) dhe përfshin ndërlidhjet me likuiditetin dhe kërkesat për kapital.

4. Banka, për qëllime të kryerjes së stress test-eve të rrezikut operacional, analizon të gjitha ngjarjet që lidhen me këtë rrezik.

5. Banka analizon ndërveprimin e mundshëm të humbjeve nga rreziku operacional, me rrezikun e kredisë dhe rreziqet e tregut.

6. Analiza e ngjarjeve të stress test-eve duhet të marrë në konsideratë gjykimin e ekspertëve, për të përfshirë ngjarjet me frekuencë të ulët dhe ashpërsi të lartë.

7. Banka harton skenarë të rënduar/të ashpër stresi, por të besueshëm/të mundshëm për të ndodhur. Supozimet mund të ndryshojnë nga supozimet e përdorura në skenarët e stresit të rrezikut të kredisë dhe të tregut. Kur banka zgjeron veprimtarinë në tregjet lokale ose ndërkombëtare, nëpërmjet bashkimeve dhe blerjeve, zhvillimit të



produkteve të reja ose zhvillimit të linjave të reja të biznesit, skenarët e rënduar të stresit duhet të bazohen në gjykimin e ekspertëve, për të kapërcyer mungesën e mundshme të informacionit historik.

8. Banka harton programin e stress test-eve, bazuar në të dhënat e brendshme dhe, kur është e mundur, edhe në të dhëna të jashtme, duke analizuar:

a) përdorimin e faktorëve shkallëzues (p.sh. në një situatë kur të dhënat e jashtme janë zvogëluar, niveli i shkallëzimit mund të reduktohet) dhe nevojat e mundshme për efekte shtesë të rrjedhura nga ndryshueshmëria e faktorit shkallëzues në situatë stresi; dhe

b) kriteret për përcaktimin e rëndësisë së të dhënave.

9. Banka, gjatë hartimit të stress test-eve merr në konsideratë edhe rrezikun ligjor, si pjesë e rrezikut operacional. Aty ku është e përshtatshme, banka vlerëson në skenarët e saj nëse fitimet e ardhshme do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar humbjet/kostot e pritshme nga rreziku ligjor dhe përfshin këtë informacion në planifikimin e saj të kapitalit.

10. Banka i mat rezultatet e stress test-eve në terma të rritjes së humbjeve të rrezikut operacional dhe ndikimit të tyre në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të bankës. Këto humbje duhet të merren parasysh gjatë parashikimit/projeksionit të raporteve të kapitalit në situata stresi.

Neni 31

Rreziku i likuiditetit

1. Banka, gjatë hartimit të programit të stress test-eve, merr në konsideratë se rreziku i likuiditetit përfshin:

a) rrezikun e likuiditetit afatshkurtër dhe afatmesëm; dhe

b) rrezikun e financimit (afatgjatë).

2. Banka bën një vetëvlerësim të faktorëve të rrezikut për aktivet, pasivet dhe zërat jashtë bilancit.

3. Banka analizon faktorët e rrezikut të lidhur me aktivet dhe pasivet, si dhe angazhimet jashtë bilancit dhe që përfshijnë, por pa u kufizuar në:

a) ndikimin e kushteve makroekonomike (p.sh. ndikimin e goditjes së normës së interesit në flukset e parave në situata emergjente);

b) ndikimin e kursit të këmbimit dhe vështirësitë e mundshme për aksesin në tregjet e këmbimit valutor;

c) burimet e likuiditetit brenda grupit dhe rrezikun e kufizimeve për transferimin e fondeve midis juridiksioneve ose subjekteve të grupit;

d) detyrimet që mund të kërkojnë të përmbushen në çdo kohë, pavarësisht afatit të maturimit, me qëllim reduktimin e rrezikut reputacional;

e) dobësitë në strukturën e fondeve/financimit, për shkak të ngjarjeve të jashtme, të brendshme ose kontraktuale;

f) norma të besueshme të tërheqjes së depozitave gjatë periudhave normale, të cilat rriten në situata stresi;

g) përqendrimin e burimeve të financimit;

h) vlerësime të rritjes së totalit të bilancit në të ardhmen.

4. Banka kryen analizat e ndjeshmërisë ndaj faktorëve të rrezikut, ku analizat duhet të sigurojnë informacionin e duhur sasior për hartimin e skenarëve të stress test-eve.

5. Banka harton tre llojet e mëposhtme të skenarëve të stresit:

a) skenar specifik, i cili supozon ngjarje specifike të bankës (p.sh. përkeqësimi i vlerësimit të cilësisë së kredisë së bankës, dështimi i kundërpartisë më të madhe që i siguron financime dhe flukse hyrëse më të larta bankës, humbja e aksesit në treg, humbja e konvertueshmërisë së monedhës, sjellja e klientëve, duke përfshirë depozituesit, ofruesit e tjerë të fondeve dhe kundërparti të tjera, për çdo skenar të ndryshëm dhe për çdo horizont kohor);

b) skenar i tregut, i cili duhet të ketë ndikim mbi një grup bankash ose mbi gjithë sektorin financiar (p.sh. përkeqësimi i kushteve të tregjeve të financimit, mjedisi makroekonomik ose rënia e vlerësimit të cilësisë së kredisë për vendet në të cilat banka operon); dhe

c) një kombinim i të dy skenarëve të mësipërm.

6. Banka përcakton horizonte të ndryshme kohore në stress test-et e saj, që mund të luhaten nga një ditë, deri në të paktën 12 muaj. Banka gjithashtu duhet të kryejë edhe stress test-e të veçanta në lidhje me rrezikun ditor (intraday) të likuiditetit. Horizonti kohor duhet të përfshijë, për shembull, materializimin e efektit të stresit në një periudhë të shkurtër kohe (deri në 30 ditë, në mënyrë që të mbulohen nevojat për fonde, pa



pasur nevojë të ndryshohet modeli i biznesit), pasuar nga një periudhë më e gjatë kohe (ndërmjet 3 dhe 12 muaj).

7. Banka kombinon stresin e rrezikut të likuiditetit afatshkurtër dhe afatmesëm, me stresin e rrezikut të financimit, duke marrë parasysh një horizont kohor prej së paku 12 muajsh.

8. Banka, gjatë hartimit të skenarëve, mund të marrë në konsideratë edhe ndikimin e ngjarjeve të stresit për lloje të tjera rreziku (p.sh. humbjet nga rreziku i kredisë, ngjarjet e rrezikut reputacional) në pozicionin e likuiditetit, si dhe mundësinë e përhapjes së situatave të stresit edhe nga banka të tjera, ose të ndikimit të rezervës së saj të likuiditetit në vlerën e tregut të aktiveve të tjera që mban banka.

9. Banka, kur është e përshtatshme, zgjeron analizën edhe në tregues të tjerë, siç janë:

a) norma/treguesi i likuiditetit dhe tregues të tjerë të përdorur, që përfshijnë, por nuk kufizohen në, treguesit mbikëqyrës të likuiditetit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, p.sh. raporti i aktiveve likuide me pasivet afatshkurtra dhe raporti i mbulimit me likuiditet;

b) rezerva e likuiditetit (aktivet likuide), mbi normat e kërkuara sipas treguesve të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike. Stress test-i i këtij treguesi duhet të përfshijë vlerësimin e ndikimit në rritjen e aktiveve të barrësuar (*encumbered*);

c) periudha kohore e mbijetesës së bankës, nisur nga kapaciteti kundërbalancues i saj, d.m.th. aftësia e bankës për të mbajtur ose për të pasur akses në likuiditet në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, në përgjigje të skenarëve të stresit;

d) kapitali dhe përfitueshmëria.

10. Banka, kur zbaton skenarë të ndryshëm të stresit, vlerëson dhe evidenton efektet kundërbalancuese të ofruara nga banka qendrore (politika monetare) dhe ndjek një qasje konservatore.

11. Treguesit e stress test-eve të likuiditetit, kur është e përshtatshme, detajohen sipas monedhave, për çdo monedhë të rëndësishme, për të bërë të mundur analizën e supozimeve të veçanta sipas monedhës për skenarë të ndryshëm (p.sh. luhatshmëria në kurset e këmbimit ose mospërputhjet e monedhave).

12. Banka, aty ku është e përshtatshme, përfshin stress test-et e likuiditetit në stress test-et e përgjithshme të saj dhe merr në konsideratë

ndryshimin e periudhave kohore që mbulojnë stress test-et e likuiditetit krahasuar me stress test-et e kapitalit. Banka vlerëson të paktën, ndikimin e rritjes së kostove të fondeve, në pasqyrën e fitim-humbjes.

KREU VI

VEPRIMET/MASAT E BANKËS BAZUAR NË REZULTATET E STRESS TEST-eve

Neni 32

Veprimet/masat e organeve drejtuese të bankës

1. Drejtoria (drejtuesit ekzekutivë) informon këshillin drejtues, komitetin e kontrollit dhe komitete të tjera në nivel këshilli drejtues (nëse ekzistojnë), për rezultatet e çdo stress test-i. Informacioni sipas kësaj pike duhet të përmbajë:

a) rezultatet e stress test-it;

b) veprimet/masat që propozohen të ndërmerren, si pasojë e rezultateve të stress test-it.

2. Organet drejtuese të bankës marrin masat e duhura për të adresuar rezultatet e stress test-eve dhe që sigurojnë në vazhdimësi mjaftueshmërinë e kapitalit, për të përballuar skenarë të stresuar.

3. Banka konsideron një gamë të gjerë të veprimeve/masave të organeve drejtuese (duke i përfshirë edhe në planin e emergjencës së administrimit të rrezikut të likuiditetit), kundrejt një sërë kushtesh të stresuara të mundshme, duke u fokusuar në të paktën një skenar të ashpër, por të besueshëm/të mundshëm për të ndodhur.

4. Banka identifikon veprimet/masat më të përshtatshme, si dhe momentin kur duhet t'i ndërmarrë ato veprime/masa, me qëllim vlerësimin e përgjigjeve të mundshme ndaj një situatë të stresuar. Banka merr parasysh që disa veprime/masa të organeve drejtuese janë të nevojshme për t'u ndërmarrë në mënyrë të menjëhershme, ndërsa disa të tjera janë të kushtëzuara nga ndodhja e ngjarjeve specifike, për të cilat duhet të identifikohen paraprakisht ngjarjet që do të aktivizojnë këto veprime/masa.

5. Veprimet/masat e organeve drejtuese duhet të jenë në përputhje me strategjitë dhe politikat e miratuara (për shembull, në kontekstin e politikave të deklarimit të dividendëve). Banka duhet të jetë konservatore në lidhje me aftësinë e saj për të ndërmarrë veprime/masa me efekte zbutëse, duke



njohur ndikimin e mundshëm të skenarëve të stresuar në tregjet e tjera.

6. Banka shpjegon ndikimin cilësor dhe sasior të situatave të stresit, para dhe pas marrjes së veprimeve/masave të organeve drejtuese me efekte zbutëse. Ndikimi përpara marrjes së veprimeve/masave të organeve drejtuese, përfshin supozimet rreth strategjisë, rritjes dhe të ardhurave përkatëse, por përjashton veprimet/masat e organeve drejtuese që nuk do të ishin të disponueshme në një situatë stresi si p.sh.: mbyllja e një linje biznesi ose zmadhimi i kapitalit.

7. Për qëllime të këtij neni, banka mund të konsiderojë si veprime/masa të përshtatshme të organeve drejtuese, veprimet/masat e mëposhtme:

- a) rishikimin e kufijve të brendshëm të rrezikut dhe të oreksit/tolerancës ndaj rrezikut;
- b) rishikimin e përdorimit të teknikave të zbutjes së rreziqeve;
- c) rishikimin e politikave, për shembull që lidhen me likuiditetin dhe financimin ose me mjaftueshmërinë e kapitalit;
- d) reduktimin e shpërndarjes së dividendëve;
- e) ndryshimet në strategjinë e përgjithshme dhe planin e biznesit, si dhe në oreksin/tolerancën ndaj rrezikut;
- f) zmadhimin e kapitalit ose rritjen e fondeve nëpërmjet financimit;
- g) etj.

KREU VII RAPORTIMI DHE MBIKËQYRJA

Neni 33

Kërkesa raportuese

1. Banka raporton në Bankën e Shqipërisë, të paktën një herë në vit, brenda muajit shtator, rezultatet e stress test-eve, sipas të dhënave të muajit qershor të çdo viti.

2. Banka, si pjesë të raportimit që paraqet pranë Bankës së Shqipërisë, përfshin edhe veprimet/masat e ndërmarra nga organet e saj drejtuese, si pasojë e rezultateve të stress test-eve.

3. Banka e Shqipërisë bën vlerësimin e rezultateve të stress test-eve dhe të veprimeve/masave të organeve drejtuese, pas raportimit të tyre nga banka.

Neni 34

Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të parashikuara në këtë udhëzim, zbaton masat mbikëqyrëse sipas nenit 74, pika 2, shkronja “c”, nenit 76, pika 1 shkronja “e” të ligjit për bankat dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në nenin 89, pika 1, shkronja “b”, të ligjit për bankat.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

VENDIM Nr. 31, datë 28.6.2019

PËR MIRATIMIN E PLATFORMËS SË DATA BAZËS PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE NGA SHOQËRITË UJËSJELLËS-KANALIZIME

Në mbështetje të nenit 14, 28, 29 dhe 31 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102),

Komisioni Kombëtar Rregullator,
në mbledhjen e datës 28.6.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi platformën e data bazës për grumbullimin e të dhënave nga shoqëritë Ujësjellës-Kanalizime,

VËREN SE:

1. Në mbështetje të pikës 1/e të nenit 14, të ligjit nr. 8102, Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) për të përmbushur mandatin e tij sipas këtij ligji, do të inkurajojë standarde dhe rregulla uniforme për të gjithë sektorin. KKRR sipas pikës 1/i, të nenit 14, të ligjit nr. 8102 ka kompetencë të nxjerrë rregulla për të ndihmuar ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të parashikuara në këtë ligj.

Referuar pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 8102, ERRU-ja ka detyrimin të paraqesë një raport mbi gjendjen e sektorit ujësjellës-kanalizime në Shqipëri, duke përfshirë, por jo e kufizuar me pronësinë, shfrytëzimin dhe kontrollin e ujësjellësve,



kapacitetin aktual të trajtimit dhe shpërndarjes si dhe parashikimin për kërkesën për ujë në të ardhmen, koston e shërbimit të furnizimit me ujë, lidhjen e këtyre çështjeve me standardin e jetesës në Shqipëri, si dhe rekomandime për veprime të nevojshme për t'u ndërmarrë nga Këshilli i Ministrave.

Referuar pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 8102, në bazë të kuadrit rregullator të krijuar nga komisioni, çdo i licencuar sipas këtij ligji është i detyruar t'i paraqesë komisionit çfarëdolloj raporti, pasqyrë financiare dhe informacioni që komisioni e konsideron absolutisht të nevojshme për operimin e garantuar, të sigurt dhe efikas të sistemit kombëtar të furnizimit me ujë dhe për funksionimin efektiv të ERRU.

2. Qëllimi i këtij vendimi është vendosja e një kuadri rregullator për monitorimin, vlerësimin dhe krahasimin e performancës së shoqërive ujësjellës-kanalizime në veçanti dhe sektorit ujësjellës-kanalizime në tërësi.

3. Objektivi kryesor i vendimit është informimi i shoqërive ujësjellës-kanalizime, mbi detyrimin për raportimin e të dhënave pranë rregullatorit, sipas platformës që ERRU-ja do të përdorë për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së sektorit UK.

4. Në pikën 1/b, të nenit 29, të ligjit 8102, përcaktohet që rregullat procedurale që nxjerr ERRU-ja për kryerjen e funksioneve që jep ky ligj të përmbajnë mundësinë për koment publik dhe në zbatim të këtij parashikimi platforma e data bazës është konsultuar paraprakisht me shoqëri ujësjellës-kanalizime të cilat ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, shërbimin e largimit të ujërave të ndotura dhe shërbimin e përpunimit të ujërave të ndotura.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi se mundësia e grumbullimit të të dhënave drejtpërsëdrejti nga shoqëritë UK, do të ndikojë në rritjen e cilësisë së raportimeve me të dhëna më të sakta dhe të argumentuara, çka do të sjellë rritjen e cilësisë së vlerësimit të performancës për shoqëritë dhe sektorin UK,

VENDOSI:

1. Miratimin e platformës së data bazës për grumbullimin e të dhënave nga shoqëritë ujësjellës-kanalizime sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur.

2. Shoqëritë ujësjellës-kanalizime do të raportojnë të dhënat pranë ERRU-së sipas platformës së data bazës, si më poshtë:

a) Të dhënat 6-mujore brenda muajit korrik të vitit aktual;

b) Të dhënat vjetore brenda datës 20 janar të vitit pasardhës;

c) Të dhënat vjetore, të konfirmuara pas auditimit të pasqyrave financiare, brenda datës 15 prill të vitit pasardhës.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime që operojnë në sektorin UK.

4. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike për njoftimin e shoqërive ujësjellës-kanalizime për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani



ANEKS 1

Tabela 1: Platforma e data bazës që duhet plotësuar nga shoqëritë UK sipas shërbimit

Shoqëria:

UJËSJELLËS + KANALIZIMET E UJËRAVE TË NDOTURA + IMPJANTI I TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA +IMPJANTI I TRAJTIMIT TË UJIT TË PIJSHËM

Nr.	Emërtimi	Njësia	Viti 2018	Shënime
Shërbimet e Ujësjetllës				
1	Popullsia në zonën juridiksionit *	nr		
2	Popullsia në zonën shërbimit të shoqërisë *	nr		
3	Popullsia që shërbehet me Çesma publike	nr		
4	Popullsia aktive me konsum uji *	nr		
5	Popullsia jo aktive *	nr		
6	Numri total i punonjësve *	nr		
7	Staf administrativ dhe organigrama e shoqërisë *	nr		
8	Vëllimi i ujit të prodhuar me sistemet me rrjedhje të lirë *	000 m ³		
9	Vëllimi i ujit të prodhuar me sistemet me ngritje mekanike *	000 m ³		
10	Vëllimi i ujit të shitur me shumicë *	000 m ³		
11	Vëllimi i ujit të blerë me shumicë *	000 m ³		
12	Vëllimi i ujit që hyn në rrjetin e shpërndarjes *	000 m ³		
13	Vëllimi i ujit të prodhuar i matur	000 m ³		
14	Vëllimi i ujit të prodhuar i vlerësuar*	000 m ³		
15	Energjia totale e konsumuar Ujësjetllës	kwh		
16	Gjatësia e tubacioneve të rrjetit të transmetimit *	km		
17	Gjatësia e tubacioneve të rrjetit shpërndarës *	km		
18	Gjatësia totale e tubacioneve të Ujësjetllës *	km		
19	Numri i defekteve në rrjetin e transmetimit *	nr		
20	Numri i defekteve në rrjetin e shpërndarjes *	nr		
21	Numri i lidhjeve të ujit me matës Familjarë	nr		
22	Numri i lidhjeve të ujit pa matës Familjarë	nr		
23	Numri i lidhjeve të ujit me matës Ente Private	nr		
24	Numri i lidhjeve të ujit pa matës Ente Private	nr		
25	Numri i lidhjeve të ujit me matës Institucione	nr		
26	Numri i lidhjeve të ujit pa matës Institucione	nr		
27	Volumi i ujit të faturuar klientë familjarë me matës	000 m ³		
28	Volumi i ujit të faturuar klientë familjarë pa matës	000 m ³		
29	Volumi i ujit të faturuar Ente Private me matës	000 m ³		
30	Volumi i ujit të faturuar Ente Private pa matës	000 m ³		
31	Volumi i ujit të faturuar Institucione me matës	000 m ³		
32	Volumi i ujit të faturuar Institucione pa matës	000 m ³		
33	Volumi i ujit të faturuar Shitje Shumice me matës	000 m ³		
34	Shuma e ujit të faturuar familjarë me matës	000 lekë		
35	Shuma e ujit të faturuar familjarë pa matës	000 lekë		
36	Shuma e ujit të faturuar Ente Private me matës	000 lekë		
37	Shuma e ujit të faturuar Ente Private pa matës	000 lekë		



38	Shuma e ujit të faturuar Institucione me matës	000 lekë		
39	Shuma e ujit të faturuar Institucione pa matës	000 lekë		
40	Shuma e ujit të faturuar Shitje Shumice	000 lekë		
41	Totali i faturuar nga tarifa fikse - Familjare	000 lekë		
42	Totali i faturuar nga tarifë fikse - Ente Private	000 lekë		
43	Totali i faturuar nga tarifë fikse - Institucione	000 lekë		
44	Totali i faturuar e Familjarëve nga tarifa volumetrike	000 lekë		
45	Totali i faturuar e Ente Private nga tarifa volumetrike	000 lekë		
46	Totali i faturuar e Institucioneve nga tarifa volumetrike	000 lekë		
47	Totali i të faturuarave nga shërbime të tjera (lidhje, rilidhje, instalime etj)	000 lekë		
48	Totali të Faturuarave Ujësjiellës	000 lekë		
49	Kosto totale e punës - Ujësjiellës *	000 lekë		
50	Kosto e stafit administrativ - Ujësjiellës	000 lekë		
51	Kosto e kimikateve - Ujësjiellës *	000 lekë		
52	Kosto e energjisë - Ujësjiellës *	000 lekë		
53	Kosto qeraje - Ujësjiellës	000 lekë		
54	Kosto e riparimit dhe mirëmbajtjes - Ujësjiellës *	000 lekë		
55	Kosto e shërbimeve të kontraktuara - Ujësjiellës *	000 lekë		
56	Kosto e blerjes së ujit *	000 lekë		
57	Kosto të tjera operationale - Ujësjiellës *	000 lekë		
58	Kosto e karburanteve - Ujësjiellës	000 lekë		
59	Kosto të tjera - Ujësjiellës *	000 lekë		
60	Kosto Direkte e Operimit (KDO) - Ujësjiellës	000 lekë		
61	Taksa dhe tatime - Ujësjiellës *	000 lekë		
62	Amortizimi - Ujësjiellës *	000 lekë		
63	Interesa + principal - Ujësjiellës *	000 lekë		
64	Provizione për rreziqe dhe shpenzime - Ujësjiellës *	000 lekë		
65	Shpenzime të tjera financiare - Ujësjiellës *	000 lekë		
66	Kosto Totale e Operimit (KTO) - Ujësjiellës	000 lekë		
67	Totali i arkëtuar nga aktiviteti kryesor Familjarë	000 lekë		
68	Totali i arkëtuar nga aktiviteti kryesor Ente Private	000 lekë		
69	Totali i arkëtuar nga aktiviteti kryesor Institucione	000 lekë		
70	Vazhdimësia e shërbimit të furnizimit me ujë	ore/dite		
71	Cilësia e ujit të pijshëm (Flet - Analiza nga Drejtoria e Higjienës)	n/a		
Shërbimet e Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura				
72	Popullsia në zonën e shërbimit të shoqërisë me kanalizime *	nr		
73	Gjatësia e tubacioneve prej betoni KUN	km		
74	Gjatesia e tubacioneve prej polietileni - plastike KUN	km		
75	Gjatesia totale e tubacioneve të Kanalizimeve	km		
76	Numri i bllokimeve të tubacioneve të kanalizimeve	nr		
77	Energjia totale e konsumuar Kanalizime	kwh		
78	Numri i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve Familjare	nr		
79	Numri i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve Ente Private	nr		
80	Numri i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve Institucione	nr		
81	Numrin i klienteve me gropa septike	nr		
82	Volumi i ujit të faturuar për kanalizimet klientë Familjarë	000 m³		
83	Volumi i ujit të faturuar për kanalizimet Ente Private	000 m³		



84	Volumi i ujit të faturuar për kanalizimet Institucione	000 m ³		
85	Totali i faturuar me sistemin e kanalizimeve Familjarë	000 lekë		
86	Totali i faturuar me sistemin e kanalizimeve Ente Private	000 lekë		
87	Totali i faturuar me sistemin e kanalizimeve Institucione	000 lekë		
88	Totali i të faturuarave nga tarifat e tjera (lidhje, rilidhje, instalime etj.)KUN	000 lekë		
89	Totali i të Faturuarave KUN	000 lekë		
90	Kosto totale e punës - KUN *	000 lekë		
91	Kosto e stafit administrativ - KUN	000 lekë		
92	Kosto e kimikateve - KUN *	000 lekë		
93	Kosto e energjisë - KUN *	000 lekë		
94	Kosto qeraje - KUN	000 lekë		
95	Kosto e riparimit dhe mirëmbajtjes KUN *	000 lekë		
96	Kosto e shërbimeve të kontraktuara KUN *	000 lekë		
97	Kosto të tjera operationale - KUN	000 lekë		
98	Kosto e karburanteve - KUN	000 lekë		
99	Kosto të tjera KUN *	000 lekë		
100	Kosto Direkte e Operimit (KDO) - KUN	000 lekë		
101	Taksa dhe tatime - KUN *	000 lekë		
102	Amortizimi - KUN *	000 lekë		
103	Interesa + principali KUN *	000 lekë		
104	Provizione për rreziqe dhe shpenzime - KUN *	000 lekë		
105	Shpenzime të tjera financiare - KUN *	000 lekë		
106	Kosto Totale e Operimit (KTO) - KUN	000 lekë		
107	Totali i arkëtuar nga aktiviteti i kanalizimeve Familjarë	000 lekë		
108	Totali i arkëtuar nga aktiviteti i kanalizimeve Ente Private	000 lekë		
109	Totali i arkëtuar nga aktiviteti i kanalizimeve Institucione	000 lekë		
Shërbimet e ITUN				
110	Popullsia që shërbehet nga ITUN nëpërmjet sistemit të kanalizimeve *	nr		
111	Popullsia që shërbehet nga ITUN nëpërmjet autoboteve per gropat septike *	nr		
112	Popullsia totale që i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujrave të ndotura *	nr		
113	Energjia totale e konsumuar ITUN	kwh		
114	Numri i lidhjeve të kanalizimeve Familjare që shkarkojnë në ITUN	nr		
115	Numri i lidhjeve të kanalizimeve Ente Private që shkarkojnë në ITUN	nr		
116	Numri i lidhjeve të kanalizimeve Institucione që shkarkojnë në ITUN	nr		
117	Numri total i lidhjeve që shkarkojnë në ITUN (Kanalizime dhe Bote)	nr		
118	Vëllimi i ujit të trajtuar Familjar që faturohet nga ITUN	000 m ³		
119	Vëllimi i ujit të trajtuar Ente Private që faturohet nga ITUN	000 m ³		
120	Vëllimi i ujit të trajtuar Buxhetore që faturohet nga ITUN	000 m ³		
121	Shuma e faturuar nga ITUN - Familjar	000 lekë		
122	Shuma e faturuar nga ITUN - Ente Private	000 lekë		
123	Shuma e faturuar nga ITUN - Institucione	000 lekë		



124	Totali i të Faturuarave ITUN	000 lekë		
125	Kosto totale e punës - ITUN *	000 lekë		
126	Kosto e kimikateve - ITUN *	000 lekë		
127	Kosto e energjisë - ITUN *	000 lekë		
128	Kosto qeraje - ITUN	000 lekë		
129	Kosto e riparimeve dhe mirëmbajtjes - ITUN *	000 lekë		
130	Kosto e shërbimeve të kontraktuara - ITUN *	000 lekë		
131	Kosto të tjera operationale - ITUN	000 lekë		
132	Kosto e karburanteve ITUN	000 lekë		
133	Kosto të tjera - ITUN *	000 lekë		
134	Kosto Direkte e Operimit (KDO) - ITUN	000 lekë		
135	Taksa dhe Tatime - ITUN *	000 lekë		
136	Amortizim - ITUN *	000 lekë		
137	Interesa + principali ITUN *	000 lekë		
138	Provizione dhe rreziqe - ITUN *	000 lekë		
139	Shpenzime të tjera financiare - ITUN *	000 lekë		
140	Kosto Totale e Operimit (KTO) - ITUN	000 lekë		
141	Shuma Totale e Arkëtuar nga trajtimi i ujërave (ITUN) - F	000 lekë		
142	Shuma Totale e Arkëtuar nga trajtimi i ujërave (ITUN) - EP	000 lekë		
143	Shuma Totale e Arkëtuar nga trajtimi i ujërave (ITUN) - IN	000 lekë		
Shërbimet e ITUP				
144	Popullsia që shërbehet nga ITUP *	nr		
145	Numri total i punonjësve *	nr		
146	Energjia totale e konsumuar ITUP	kwh		
147	Vëllimi i ujit që futet në impjant për tu trajtuar *	000 m ³		
148	Kosto totale e punës - ITUP	000 lekë		
149	Kosto e kimikateve dhe materialeve teknologjike- ITUP *	000 lekë		
150	Kosto e energjisë - ITUP	000 lekë		
151	Kosto qeraje - ITUP	000 lekë		
152	Kosto e riparimeve dhe mirëmbajtjes - ITUP	000 lekë		
153	Kosto e shërbimeve të kontraktuara - ITUP	000 lekë		
154	Kosto e karburanteve ITUP	000 lekë		
155	Kosto të tjera operationale - ITUP	000 lekë		
156	Kosto Direkte e Operimit (KDO) - ITUP	000 lekë		
157	Taksa dhe Tatime - ITUP	000 lekë		
158	Amortizim - ITUP	000 lekë		
159	Interesa + principali ITUP	000 lekë		
160	Provizione dhe rreziqe - ITUP	000 lekë		
161	Shpenzime të tjera financiare - ITUP	000 lekë		
162	Kosto Totale e Operimit (KTO) - ITUP	000 lekë		
Të Dhëna në Total për të tre Shërbimet (U + KUN + ITUN +ITUP)				
163	Shuma totale e arkëtuar nga tarifa fikse (F + EP + IN)	000 lekë		
164	Shuma Totale e Arkëtuar nga aktiviteti kryesor (Uje+KUN+ITUN) - F	000 lekë		
165	Shuma Totale e Arkëtuar nga aktiviteti kryesor(Uje+KUN+ITUN) - EP	000 lekë		
166	Shuma Totale e Arkëtuar nga aktiviteti kryesor (Uje+KUN+ITUN) - IN	000 lekë		



167	Shuma Totale e Arkëtuar nga aktiviteti i Shitjes me shumicë të ujit	000 lekë		
168	Shuma Totale e Arkëtuar nga të gjitha veprimtaritë Ujësjiellës	000 lekë		
169	Shuma Totale e Arkëtuar nga të gjitha veprimtaritë KUN	000 lekë		
170	Shuma Totale e Arkëtuar nga trajtimi i ujrave ITUN	000 lekë		
171	Shuma e arkëtuar nga debitorët *	000 lekë		
172	Shuma Totale e Arkëtimit koherent *	000 lekë		
173	Shuma Totale e Subvencioneve operacionale	000 lekë		
174	Ankesa nga konsumatorët	nr .		
175	Aktivet Afatgjata *			
176	Aktive Afatgjata Jomateriale	000 lekë		
177	Toka	000 lekë		
178	Ndërtesa	000 lekë		
179	Impjante, makineri dhe mjete	000 lekë		
180	Tubacione	000 lekë		
181	Pajisje zyre e informatike	000 lekë		
182	Inventar i imet afatgjatë *	000 lekë		
183	Parapagime për aktive materiale dhe në proces *	000 lekë		
184	Totali i Aktiveve	000 lekë		
185	Shtesat dhe Pakësimet *			
186	Aktive Afatgjata Jomateriale	000 lekë		
187	Toka	000 lekë		
188	Ndërtesa	000 lekë		
189	Impjante, makineri dhe mjete	000 lekë		
190	Tubacione	000 lekë		
191	Pajisje zyre e informatike	000 lekë		
192	Inventar i imët afatgjatë	000 lekë		
193	Parapagime për aktive materiale dhe në proces	000 lekë		
194	Totali i ndryshimeve në Aktive Afatgjata	000 lekë		
195	Amortizimi i akumuluar *			
196	Aktive Afatgjata Jomateriale	000 lekë		
197	Toka	000 lekë		
198	Ndërtesa	000 lekë		
199	Impjante, makineri dhe mjete	000 lekë		
200	Tubacione	000 lekë		
201	Pajisje zyre e informatike	000 lekë		
202	Inventar i imët afatgjatë	000 lekë		
203	Parapagime për aktive materiale dhe në proces	000 lekë		
204	Totali i Amortizimit të Akumuluar	000 lekë		
205	Baza e Aseteve të Rregulluara	000 lekë		
*Për detaje të hollësishme shiko Udhëzuesin				

**VENDIM****Nr. 32, datë 10.7.2019****PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
DËNIMIN ADMINISTRATIV TË
SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
DIVJAKË SHA**

Në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102),

Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 10.7.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Miratimi i projektvendimit ‘Për fillimin e procedurës për marrjen e masave administrative ndaj shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a.’”,

konstatoi:

Në zbatim të urdhrit të Kryetarit nr. 47, datë 24.4.2019, “Për miratimin e planit të inspektimit”, autorizimit nr. 55, prot, datë 30.4.2019 dhe platformës së inspektimit nr. 133/1 prot, datë 30.4.2019, Enti Rregullator i Ujit, në datën 22.5.2019, inspektoi veprimtarinë e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a. (UK Divjakë).

Komisioni Kombëtar Rregullator i Entit Rregullator të Ujit (KKRR) u njoh me Raportin e inspektimit nr. 55/2 prot, datë 13.6.2019, përgatitur nga grupi i inspektimit, i cili iu njoftua shoqërisë UK Divjakë dhe Bashkisë Divjakë me shkresën nr. 199 prot, datë 25.6.2019 me lëndë “Dërgim i Raportit të inspektimit për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a.”.

Shoqëria UK Divjakë ushtron veprimtari pa licencë, prej kohës kur ka mbaruar afati i licencës lëshuar me vendim të KKRR nr. 17, datë 3.4.2013 “Për licencim për herë të parë Ndërmarrja Ujësjiellës Divjakë”, deri ditën e inspektimit.

Shoqëria UK Divjakë sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me tarifa të pa miratuara nga ERRU-ja.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën e dënimit administrativ të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a. për kundërvajtjen administrative “Ushtrimi i veprimtarisë pa licencë”.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a. ka të drejtën e ankimit kundër këtij vendimi brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Divjakë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

VENDIM**Nr. 33, datë 10.7.2019****PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME
VAU-DEJËS SHA**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 10.7.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vau-Dejës sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vau-Dejës (UK Vau-Dejës) me shkresën nr. 18 prot, datë 5.2.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të



Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik të UK Vau-Dejës në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Vau-Dejës ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 11 057 banorë në Bashkinë Vau-Dejës;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Mark Ndoci zotëron diplomë Bachelor në Inxhinieri Mekanike marrë në maj të vitit 2018 dhe ka 1 vit përvojë në profesion.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vau-Dejës, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për mos lejinin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Vau-Dejës, rekomandon:

- Shoqëria UK Vau-Dejës duhet të punojë në drejtëm të zgjerimit të zonës së shërbimit në mënyrë që të gjithë banorët e Bashkisë Vau-Dejës të marrin shërbimin e furnizimit me ujë

dhe largimit të ujërave të ndotura nga kjo shoqëri me cilësi dhe brenda standardeve.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Vau-Dejës është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Vau-Dejës sh.a. me NUIS: L67302001M në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime UK Vau-Dejës sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor - znj. Klomentina Drini;

b) Drejtues teknik - z. Mark Ndoci.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Vau-Dejës sh.a. është:

Bashkia Vau-Dejës.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Vau-Dejës sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime UK Vau-Dejës sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

**VENDIM****Nr. 34, datë 10.7.2019****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 41, DATË 6.10.2017,
“PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS
GRAMSH”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 10.7.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 6.10.2017, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Gramsh’”, i ndryshuar”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës Gramsh (U Gramsh) me shkresën nr. 445 prot, datë 28.5.2019, me lëndë “Përcjellje e dokumenteve të nevojshëm për ndryshimin e drejtuesit teknik” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së U Gramsh, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë U Gramsh me vendimin nr. 41, datë 6.10.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Gramsh”, i ndryshuar me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë U Gramsh sh.a, z. Bledjan Koçi, zotëron diplomë master shkencor në Inxhinieri Hidroteknike, marrë në nëntor 2017.

5. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e U Gramsh sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i U Gramsh është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR nr. 41, datë 6.10.2017 “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Gramsh”, i ndryshuar bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Teknik z. Bledjan Koçi”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

VENDIM**Nr. 37, datë 11.7.2019****PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME
MALLAKASTËR SHA**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit



dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 11.7.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Mallakastër sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Mallakastër (UK Mallakastër) me shkresën nr. 316 prot, datë 10.6.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Mallakastër në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Mallakastër ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për 16 792 banorë (4198 klientë) të Bashkisë Mallakastër, si më poshtë:

- Zona e shërbimit me furnizim me ujë dhe kanalizime nga shoqëria UK Mallakastër:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Mallakastër	Popullsia e shërbyer
1	Mallakastër	11 628
2	Aranitas	272
6	Greshicë	1 176
7	Hekal	2 376
9	Qendër Dukas	1 340
TOTALI		16 792 banorë

Shënim: UK Mallakastër për pjesën tjetër të njësive administrative nuk është pajisur me akt miratim higjieno-sanitar.

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Kliton Aliaj, zotëron diplomë Bachelor në Inxhinieri Gjeoburime, profili Inxhinieri Naftë, viti 2012.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Mallakastër, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për mos lejin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Mallakastër, rekomandon:

- Shoqëria UK Mallakastër duhet të aplikojë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura;

- Shoqëria UK Mallakastër duhet të punojë në drejtim të pajisjes së sistemeve të furnizimit me ujë së të gjithë zonës me akt miratimi higjieno-sanitar.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Mallakastër është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Mallakastër sh.a. me NUIS: K47605804N në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.



2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues Ligjor – Erjon Zenelaj;
- b) Drejtues Teknik – Kliton Aliaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a. është:

Bashkia Mallakastër: Njësitë Administrative Mallakastër: Aranitas, Greshicë, Hekal, Qendër Dukas

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 41, datë 27.8.2019

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË
NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJIJELLËS-KANALIZIME
LUSHNJË SHA**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr.

40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 27.8.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

1. Shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë” (UK Lushnjë) me shkresën nr. 700 prot, datë 26.6.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” për të tre kategoritë e konsumatorëve, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës, për vendosjen e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse të shoqërisë UK Lushnjë, në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 63 datë 6.9.2018, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Lushnjë për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK, për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit, në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”

3. UK Lushnjë, nëpërmjet shkresës nr. 700 prot, datë 26.6.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” për të tre kategoritë e konsumatorëve të paraqitur në tabelën më poshtë.



Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoritë e klientëve	Tarifat aktuale		Tarifat e propozuara	Diferenca	
	Njësitë administrative		E gjithë zona shërbyer	Njësitë administrative	
	Lushnjë, Kolonjë, Fier-Shegan, Dushk	Bubullime, Allkaj, Krutje, Golem, Ballagat, Hysgjokaj, Karbunarë Poshnje		Lushnjë, Kolonjë, Fier-Shegan, Dushk	Bubullime, Allkaj, Krutje, Golem, Ballagat, Hysgjokaj, Karbunarë, Poshnje
A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³
1. Klientë familjarë	58	60	65	+7	+5
2. Klientë publik	130	100	147	+17	+47
3. Klientë privat	140	100	147	+7	+47
B. Tarifë volumetrike për KUN	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³
1. Klientë familjarë	17	0	17	-	+17
2. Klientë publik	21	0	22	+1	+22
3. Klientë privat	24	0	25	+1	+25
C. Tarifë fikse	Lekë/muaj	Lekë/muaj	Lekë/muaj	Lekë/muaj	Lekë/muaj
1. Klientë familjarë	100	0	150	+50	+150
2. Klientë publik	200	0	200	-	+200
3. Klientë privat	200	0	200	-	+200
D. Shitje e ujit me shumicë	32 lekë/m³		-	-	

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezultojnë se treguesit e arritur të performancës për vitin 2017 dhe objektivat e propozuara nga shoqëria UK Lushnjë për vitin 2019, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me treguesit kryesorë të performancës për vitet 2017–2018–2019 (sipas shoqërisë)

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Treguesit e performancës		
		Viti 2017	Viti 2018 (faktik)	Viti 2019 (i parashikuar)
Mbulimi i kostove O&M	%	78	95	104
Mbulimi i kostove totale	%	48	59	68
Uji pa të ardhura	%	80.2	75.2	70.6
Mbulimi me ujë	%	63	64	66
Mbulimi me KUN	%	29	28	31
Niveli i matjes	%	94	96.5	100
Norma e arkëtimit korente	%	78	81	85
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	7	7	7
Eficiencia e stafit	staf/1000 lidhje	6.7	6.9	6.6

5. Referuar kërkesës së shoqërisë dhe dokumentacionit shoqërues, rezultojnë se:

a) Treguesi Mbulimi i kostove të O&M me faturim, synon të arrijë nivele mbi 100% për vitin 2019, nga niveli 95% që është aktualisht.

b) Treguesi Ujë pa të ardhura, për vitin 2017, është në nivelin 80.2%. Sasia e ujit të prodhuar dhe atij të blerë është 7.376.032 m³ ujë. Humbjet administrative janë 49% e humbjeve totale, ndërsa ato reale 30.8% e tyre. Për vitin 2019 shoqëria parashikon që niveli i humbjeve të jetë 70.6%.

Nisur nga raportimi në bilancin e ujit për vitin 2017, shoqëria, deri në fund të vitit 2019, ka hapësira për përmirësimin e dukshëm të treguesit UPA. Për të arritur përmirësim të këtij treguesi shoqërisë i duhet të eliminojë humbjet e shkaktuara nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes, gjatë kësaj periudhe, duke i ulur humbjet administrative me 15% ose në sasinë 541 879.2 m³. Kjo sasi uji e reduktuar nga këto humbje do të rrisë sasinë e ujit të faturuar duke i kaluar lidhjet e paligjshme në klientë me kontratë.



c) Sh.a. UK Lushnjë raporton një popullsi totale në zonën e juridiksionit prej 128.717 banorë, ku rreth 36% e tyre i takon zonave të marra nën juridiksion pas Reformës Territoriale. Treguesi Mbulimi me ujë aktualisht është 64%, kundrejt 71% që ishte para riorganizimit të shoqërisë.

d) Para riorganizimit të shoqërisë, shërbimi i KUN i ofrohej 50% të popullsisë së qytetit të Lushnjës. Zgjerimi i zonës së juridiksionit nuk është shoqëruar dhe me popullsi të shërbyer me kanalizime kështu që ky tregues ka pësuar rënie në nivelin 29%. Aktualisht 71% e popullsisë nuk kanë rrjet të KUN dhe ujërat e papërpunuara shkarkohen në kanale të hapura. Me financimin e projekteve të KfW, gjatë vitit 2017, janë kryer investime për ndërtimin e linjës së KUN në lagjen Zhamë, të njësisë administrative Dushk. Edhe për vitin 2019 niveli i këtij treguesi nuk pritet të pësojë ndryshim duke qenë se realisht gjatë vitit 2019 nuk priten të zbatohen investime brenda zonës së shërbimit. Investimet e pritshme nga Projekti bashkiak III dhe IV financuar nga KfW fillojnë zbatimin e tyre në fund të vitit 2019 ose në fillim të vitit 2020.

e) Niveli i Matjes Shoqëria në mbyllje të vitit 2019 nuk do të ketë asnjë klient pa matës.

f) Shoqëria raporton Normën e arkëtimit korente për vitet 2017-2018-2019 (parashikimi) respektivisht 78%, 81% dhe 85%. Ky tregues në rritje tregon për një angazhim të shoqërisë për arkëtimin në kohë të faturave për shërbimet UK. Arkëtimi i debive të vjetra gjatë vitit 2018 në vlerën 48 milion lekë ka rritur në nivelin mbi 100% treguesin e Normës së Përgjithshme të Arkëtimit.

g) Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë. Shoqëria raporton se ofron shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm për gjithë zonën e shërbimit mesatarisht 7 orë/ditë. Zona ku është bërë investimi në qytet, që përfshin 5.152 lidhje furnizohet me 17 orë në ditë, ndërsa zonat më problematike janë zonat e bardha. Parashikimi për vitin 2019 raportohet të mbahet në të njëjtat nivele 7 orë në ditë.

h) Eficiencia e Stafit si tregues në vitin 2017 ka qenë në vlerën 6.7 punonjës për 1000 lidhje. Duke qenë se në vitin 2018 shoqëria shërbimin e rojeve e kryen edhe nga të tretë, marrja në konsideratë e këtyre të fundit e përkeqëson këtë tregues për vitin 2018 në nivelin 6.9 staf/1000 lidhje. Parashikimi për 2019 do të jetë 6.6 staf/1000 lidhje, përmirësim i cili do të vijë nga rritja e numrit të lidhjeve duke mbajtur të pandryshuar numrin e punonjësve.

Nevoja e ndryshimit të tarifave nga ana e UK Lushnjë me qëllim gjenerimin e të ardhurave shtesë argumentohet si më poshtë,

a) Aplikimin për herë të parë pas zgjerimit të zonës së shërbimit sipas Metodologjisë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, bazuar në analizën e gjendjes teknike dhe ekonomike të saj, konkretisht analizën e kostove dhe të ardhurave për shërbimet e ofruara, analizën dhe përcaktimin e objektivave për treguesit e performancës.

b) Kalimin e periudhës tranzitore, në kushtet kur një zonë e re bëhet pjesë e zonës së shërbimit të operatorit duke propozuar unifikim të tarifave, në zbatim të nenit 16, pika 1, të vendimit nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”.

c) Përballimin e kostove të operim & mirëmbajtjes në nivelin mbi 100% nëpërmjet të ardhurave të siguruara nga tarifa.

d) Rritjen e qëndrueshmërisë financiare, si një kriter bazë për t’u kualifikuar për investimet në vazhdimësi të Programit të Infrastrukturës Bashkiake si pjesë e marrëveshjes mes Qeverisë dhe KfW.

e) Përmirësimin e disa treguesve të performancës si Niveli i matjes 100% dhe Uji pa të ardhura 70.6%.

f) Mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit me tarifat e reja të propozuara.

6. ERRU, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ka kërkuar nga UK Lushnjë informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

7. ERRU, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Lushnjë të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;



b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar (ligji nr. 9121), për mos lejin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;

c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e Konsumatorëve” të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) Orientimin drejt Mbulimit të kostove O&M në nivelin 96% pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që mbulon 78% të këtyre kostove.

e) Tarifatat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifatat duhet të jenë të përballueshme.

f) Tarifatat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

g) Propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU, e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar për sa i përket tarifave volumetrike për dy shërbimet ujë dhe kanalizime, si dhe tarifën fikse të shërbimit.

h) Observacionin nga shoqëria UK Lushnjë sipas shkresës nr. 700/5 prot, datë 30.5.2019 në lidhje me projekt vendimin e ERRU-së sipas mbledhjes së KKRR-së me datë 13.5.2019 për tarifatat e shoqërisë UK Lushnjë.

8. Referuar observacionit të mësipërm të shoqërisë UK Lushnjë dhe seancës së zhvilluar në takimin më datën 19.06.2019 mes Komisionit Kombëtar Rregullator, stafit të ERRU, përfaqësues të UK Lushnjës dhe konsulentë të saj me qëllim diskutimin, arsyetimin dhe sqarimin e situatës së paraqitur në këtë shkresë. Në përfundim të këtij takimi Komisioni Kombëtar Rregullator konkludoi si më poshtë:

- Të rishikohen kostot e energjisë elektrike dhe kostot e blerjes së ujit me shumicë duke konsideruar jo të saktë vlerën që UK Lushnjë ka paraqitur në aplikim. Pra, llogaritjet do të bazohen në kostot që UK Lushnjë ka paraqitur në argumentet e shkresës nr. 700/5 për pjesën e kostove të energjisë elektrike që OSSHE ka mbi faturuar para vitit 2018 dhe e ka korrigjuar

(kompensuar) në vitin 2018, argument i paraqitur për herë të parë pranë ERRU-së.

- Të mos merren në konsideratë të ardhurat nga reduktimi i humbjeve nga eliminimi i lidhjeve të paligjshme për vitin 2019 nga i cili parashikoheshin të gjenerohen 21 milion lekë të ardhura, sepse legalizimi i lidhjeve të paligjshme ishte realizuar gjatë vitit 2018 vërtetuar nga bilanci i ujit, të cilin shoqëria e ka paraqitur pranë ERRU-së në prill të vitit 2019. Pas kësaj faze pa u realizuar investimet e parashikuara nga KFW me Projektin Bashkiak III dhe IV në rrjetin shpërndarës efekti i të cilave do të vërehet pas vitit 2019, paraqitet mjaft i vështirë reduktimi i mëtejshëm i humbjeve. Nga ana tjetër Shoqëria paraqet paqartësi për vazhdimësinë e reduktimit të humbjeve nga lidhjet e paligjshme pa investime në rrjete, rrjedhimisht niveli i humbjeve mbetet 70.6%.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifatat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendim nr. 42, datë 09.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifatat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “Për mbrojtjen e Konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,



VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjetellës-Kanalizime Lushnjë si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas njësive administrative	
	Lushnjë, Kolonjë, Fier-Shegan, Dushk	Bubullime, Allkaj, Krutje, Golem, Ballagat, Hysgjokaj, Karbunarë Poshnje
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lekë/m ³	Lekë/m ³
Konsumatorë familjarë	62	62
Konsumatorë publik	130	110
Konsumatorë privat	140	110
Tarifë volumetrike për KUN	Lekë/m ³	Lekë/m ³
Konsumatorë familjarë	17	17
Konsumatorë publik	21	21
Konsumatorë privat	24	24
Tarifë fikse	Lekë/muaj/lidhje	Lekë/muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	100	100
Konsumatorë publik	200	100
Konsumatorë privat	200	100

Me tarifat e aprovuara sipas këtij vendimi, situata e realizimit të treguesve financiarë për vitin 2018 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme.

Zërat për llogaritjen e mbulimit të kostove O&M	Të dhënat e ERRU sipas modelit të aplikimit	Të dhënat e saktësuara
	2019	2019
Kostot e energjisë	42,000	56,000
Kostot e blerjes së ujit me shumicë	10,000	12,173
Kostot e punës	103,000	103,000
Kostot të tjera O&M	30,386	40,336
Kostot O&M	185,386	211,509
Të ardhurat nga aktiviteti UK	187,139	191,156
Të ardhurat të tjera	12,435	12,435
Të ardhura nga reduktimi i humbjeve	21,460	-
Totali i të ardhurave nga faturimet	221,034	203,591
Norma e arkëtimit të përgjithshme (*)	96.7%	96.7%
Totali i arkëtuar	213,740	196,283
Mbulim i kostove O&M me faturim	119%	96%
Mbulimi i kostove O&M me arkëtim	115%	93%

(*)Kjo vlerë i është referuar modelit të aplikimit të plotësuar nga shoqëria UK Lushnjë për tarifat e reja të propozuara pranë ERRU-së

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës të vitit 2020 për shoqërinë UK Lushnjë të jenë:

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit të përcaktuar nga ERRU-ja
Mbulimi i kostove O&M me faturim	%	96
Mbulimi i kostove O&M me arkëtim	%	93
Mbulimi i kostove totale	%	65
Uji pa të ardhura	%	70.6
Niveli i matjes	%	100



Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	7
Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	6
Mbulimi me ujë	%	66
Mbulimi me KUN	%	31
Norma e arkëtimit korente	%	85

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Lushnjë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Lushnjë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Vendimi nr. 17, datë 5.5.2017 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. ‘UK Lushnjë Qytet’ dhe vendimi nr. 3, datë 17.1.2016 për sh.a. ‘U Lushnjë Fshat’” shfuqizohen.

6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.10.2019 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM **Nr. 42, datë 30.8.2019**

PËR DËNIMIN ADMINISTRATIV TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME DIVJAKË SHA

Në mbështetje të pikës 1/h, të nenit 23, dhe pikës 1/ç, të nenit 32/1 të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102),

Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 30.8.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Miratimi i projektvendimit ‘Për dënimin administrativ të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Divjakë sh.a.’”,

konstatoi:

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 32, datë 10.7.2019, “Për fillimin e procedurës për dënimin administrativ të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Divjakë sh.a.” (vendimi i KKRR-së nr. 32) filloi procedurën për marrjen e masës administrative “Gjobë në masën 300 000 lekë” ndaj shoqërisë UK Divjakë, për shkeljen administrative “Ushtrimi i veprimtarisë pa licencë”.

Në zbatim të procedurës administrative të parashikuar në pikën 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 23, të ligjit nr. 8102, vendimi i KKRR-së nr. 32, iu njoftua shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Divjakë sh.a, me shkresën nr. 276 prot, datë 24.7.2019.

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Divjakë sh.a. nuk e ankimoi, vendimin e KKRR-së nr. 32, brenda afatit ligjor.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Divjakë sh.a. dënohet me gjobë, në shumën 300 000 lekë, për kundërvajtjen administrative “Ushtrimi i veprimtarisë pa licencë”.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit të njoftojë Shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Divjakë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Gjykatës Administrative Tiranë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni mbi vendimin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM *(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 882(3602), datë 10.7.2019 vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Rregjina Zefi, e datëlindjes 15.5.1952, dhe caktimin si kujdestare ligjore të saj kërkuesin Mond Zefi.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë